




Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3413 · e shtunë/e diel, 14-15 korrik 2018

20°C | 31°C

15 DEN



KOHA për
enigmë

Fq.12-15

FORUM

SS-Faktori:
"Sela" e
"Sazdovski"



E pata nisur një seri shkrimesh, që dua ta ndërpres pa dashjen time. Pas Micskovskit dhe Zaevit, radhën e kisha për shkrimin "Të (mos) jesh Ali Ahmeti", por mbe-ti për javën tjetër, me kusht që të mos dalë ndonjë temë tjetër që t'ma prishë planin. Si kjo për vrasjen e pjesëtarit të grupit të tifozeve "komitet". Dua ta them haptas se kërkoj dënimin e merituar për sulmuesit e tij, por dhe se duhet të jemi të brengosur për këtë dukuri që...

Fq.10

AKTUALE

Kisha serbe
kërcënon
kishën
bullgare

Fq.5

EDITORIAL

Dikur
refuzoheshin
të botohen,
sot gjithçka
quhet vepër

Fq.2



QEVERIA DHE ANALISTËT KËRKOJNË KYÇJEN EDHETË OPOZITËS

SHUMË DETYRA DERI TE ANËTARËSIMI I PLOTË



Maqedonia pritet të avancojë legjislacionin që prek fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Buxhet më të madh për ushtrinë, sidomos në pajisjet ushtarake dhe blerjen e armëve moderne, si dhe asimilimin apo zhdukjen e armëve të vjetra njëjtë siç ka bërë Shqipëria dhe shtete tjera të rajonit. Anëtarësimi në NATO do të kushtojë Maqedonisë dhe kontribut financiar deri në 2 për qind të Bruto Prodhimit Vendor

Fq.3

Lëndët gjyqësore janë ndarë "dorë më dorë"

Shkup, 13 korrik - Sistemi elektronik i ndarjes së lëndëve në Gjykatën Penale të Shkupit (GJPSH) dhe Gjykatën Supreme, në masë të madhe nuk ka funksionuar në formën e duhur. Ndonëse i vonuar, Ministria e Drejtësisë ditë më parë e publikoi Raportin e Grupit të punës, i cili gjatë vitit të kaluar realizoi kontroll mbi AKMIS-in në gjykatat e apostrofuara. Të dhënat e siguruar nga Grupi i punës i Ministrisë së Drejtësisë,

kanë konstatuar se përveç në vitin 2013, në GJ-PSH, nuk është realizuar plan vjetor për menaxhimin dhe zvogëlimin e lëndëve të pazgjidhura. Për këtë arsye, siç thuhet në Raportin e AKMIS-sistemit, deri me 26 tetor të vitit të kaluar nuk janë zgjidhur rreth 860 lëndë. Gjatë takimit me Grupin e punës të Ministrisë së Drejtësisë, ushtruesi i detyrës së asaj kohe kur është realizuar kontrolli...

Fq.5



EDITORIAL

DIKUR REFUZOHESHIN TË BOTOHEN, SOT GJITHÇKA QUHET VEPËR



Emin AZEMI

Sot të botosh një libër, është më lehtë se të qërosh një farë kungulli. Ka plot kunguj që vetes i thonë autorë, madje edhe pasi të kenë mbrojtur ndonjë titull "mr." a "dr.", por ja që gjenden botues që nuk përdorin kurrfarë "filtri" para se të botojnë një biçim vepre, apo të aplikojnë një sistem antiplagjiaturë për të parandalu vjedhjen që shumë lehtë të ne shitet si "kontribut shkencor". Të ashtuquajturat "vepra" që si patericë-bashkautorësie kanë "copy paste" teknologjinë e "hulumtimit shkencor", vazhdojnë të stolisin bibliotekat e fakulteteve tona dhe askush nuk e merr guximin intelektual e qytetar t'i denoncojë këta cuba të internetit që brenda natës promovohen në kryekunguj që ta trullavin kryet me tuj e thirrje akademike.

Sot na u ka shndërru ky ambient yni social e kulturor në rasaditshte kungujsh të zbrazur që shumë lehtë mund të përdoren edhe si gjysmehelmeta për kokat e halabakëve nëpër bahçe. Mbase, këta halabakë po ndodhë që ta vrasin konkurrencën e lirë me prurjet e tyre kungull-vlerash, dhe për rrjedhojë pashmangshmërisht po vjen dekurajimi i talentëve të rinj e që kanë vërtetë se çka të ofrojnë. Njoh shumë djem e vajza në Perëndim që kanë mbaru master e doktoraturë, por që nuk kanë guxim të dalin me libër autorial sepse profesorët e tyre i kanë mësuar të bëjnë dallim në mes të punës rutinore dhe hulumtimit të njëmendët shkencor. I kanë mësuar se deri në sa për qind të punimit shkencor lejohet të ketë pjesë nga punimet e të tjerëve dhe cila metodologji e citimit dhe aparaturës shkencore të përdoret, në mënyrë që punimi të del sa më pak i ndikuar nga të tjerët. Me fjalë të tjera, çmimi të jesh origjinal, vetvetja, është më i larti dhe ai nuk këmbëhet me kurrfarë favorit tjetër.

Recenzentët dhe redaktorët e dikurshëm vlerësonin nëqoftëse duhej apo jo të botohet një libër. Tani punën e recensentëve e redaktorëve e kanë zënë botuesit gjithpërfshirës, që njëkohësisht kryejnë edhe punën e shtypshkronjës edhe të administratorit financiar, edhe të agjentit tregtar edhe të promotorit të kungullishtës së patrazuar nga kritika serioze që do të bënte diferencimin e vlerave nga jovlerat.

Dikur refuzoheshin të botohen, sot gjithçka quhet vepër. Dikur, kishte edhe plot raste që autorë e vepra nuk botoheshin, por që më vonë kritika dhe lexuesi i shpallte kryevepra.

Ja cilat prej kryeveprave të letërsisë, apo librave mjaft të njohur janë refuzuar nga botuesit? Kjo furi refuzimesh ka përfshirë emra të shquar të letrave, siç ishin Oruelli, Stephen King, Harper Lee, J.K. Roulling, madje edhe Prusti. Ky i fundit madje e kishte botuar me paratë e veta librin e tij të parë!

Kur shkroi librin alegorik "Ferma e kafshëve", Xhorxh Oruell ishte i njohur, mirëpo pjesa dërrmuese e shtëpive botuese hezitonin ta botonin, për shkak të frymës së tij të fortë politike. Në këtë "libër gri" refuzimesh, ka shkruar emrin edhe Tomas Elioti, atëherë drejtues i shtëpisë botuese "Faber and Faber". Ai ishte shprehur se "veprës nuk i mungon cilësia, por është shumë kritike ndaj Stalinit".

Pastaj, fituesja e çmimit "Pulitzer", 1951, amerikania Harper Lee, pothuajse e humbi dorëshkrimin e romanit të saj të vetëm "Të vrasësh zogën përqeshës", kur iu refuzua fillimisht nga botuesit. Thonë, që ajo i hodhi faqet e librit, por ia mblodhi agjenti i saj, i cili e detyroi më pas ta përfundonte me një mbyllje tjetër, që libri të botohej më 1960-ën.

Të njëjtin fat ka pësuar edhe romani për fëmijë, që është edhe libri me shitje rekorde sot në botë "Harry Potter" Autorja J.K. Roëling, ka qenë aq e varfër, sa që s'ka patur as kompjuter në shtëpi dhe fillimisht librin e ka shkruar me dorë. Një shkak i mjaftueshëm ky, që botuesit ta shohin me syrin e një andralle më tepër. Gjithashtu, ata e kanë etiketuar atë edhe si një libër mjaft të gjatë për fëmijë. Refuzime këto, që duhet t'i kenë bërë me dhimbje koke botuesit, kur libri theu rekordet "bestseller".

Gjithashtu refuzimit s'i ka shpëtuar as i famshmi i letërsisë horror, Stephen King, veprat e të cilit janë bërë të gjithë skenare filmash po aq të famshëm. Atij ia kthyen librin e parë të botuar "Carrie". Mësohet që ai të ketë thënë pas refuzimit: "Në fakt, kush do të donte të lexonte një libër për një vajzë të varfër me probleme menstruale?"

Si rast i veçantë përmendet edhe Marsel Proust, shkrimtari më i madh ndër të refuzuarit, i cili e pagoi me paratë e veta botimin e "Suanit", më 1913.

Lista mund të jetë edhe më e gjatë, por në gjithë atë oqean autorësh e dijesh të përbotshme, mbetën vetëm ata që ne sot me të drejtë i quajmë arketipe vlerash të pakapërcyeshme. Kishte shumë autorë që përpëliteshin që të lënë gjurmë në shekujt e mëvonshëm, madje edhe në kohën e Gëtes, bie fjala, por vetëm ky i fundit bashkë me një brez shkrimtarësh gjermanë, ku bënte pjesë edhe Shileri, arritën të jenë bartësit kryesor të lëvizjes letrare "Sturm und Drang" ("Stuhi e vrull").

Sigurisht që edhe plehu i nesërm do të merr në gjun vetë gjithë këtë kungullishtë "letraroshkencore" të sotme, por kjo nuk vjen vetvetiu nëse nuk aktivizohet një vetëdije pak më joportune e atyre që dinë dhe munden të diferencojnë vlerën nga jovlera.

PARALAJMËRIMI I KOBSHËM

"Paralajmërim i kobshëm; Kosova e Shqipëria, do zbrazen... Nëse, sipas sondazhit të Monitor.al, (që paska bërë në gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor) Kosovën, do e braktisin 48% të qytetarëve, kurse Shqipërinë 43%, shkak i punësimit, atëherë, unë i them politikës injorante gjithëshqiptare; Mbyllni, 'dyqanet' e klaneve mafioze, s'bashku me kupolat e krimit e korrupsionit të paparë në gjithë rajonin! Sepse, thjesht, s'do keni më as blerje votash, as premtime bosh, e as premtime rrenacake, as klientelë militante, as verbëri partiake, as nënshtrim të tejskajshëm... e shumë e shumë do privilegje tjera të pamerituara", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, sociologu nga Kosova, Fadil Maloku.



SI DUHET TË VISHEMI DHE TË SILLEMI?

"Kohëve të fundit e keni parë se si vishet dhe veqanërisht si mbathet kryeministri i Republikës së Shqipërisë, Edi Rama. Gjatë takimeve diplomatike të shteteve ballkanike dhe ato të NATO-s, e keni parë se si sillen Ramush Haradinaj dhe Edi Rama. E keni parë se si këta dy u shkojnë pas burrështetasve, që në këtë rast ishin gra, duke u munduar që të bisedojnë me to. Haradinaj i fliste Angela Merkelit edhe pse ajo jepte shenja se nuk dëshironte të bisedonte. Haradinaj e zbatonte stilin: s'ka lidhje a po don ti, unë po du.

Edi Rama me patika (atlete) para udhëheqësve të botës. Me dy duart e tija të gjata e kapte nga pas në supe Theresa May-in. Demek, të kam shoqe të ngushtë apo të kam pikë të dobët. Ajo e ngrata e ulte kokën dhe mundohej ta minimizonte këtë rast duke e injoruar sjelljen e pahijshme të kryeministrit shqiptar.

Pyetja: pse këta 'udhëheqës' tanë i bëjnë këto budallakia? Përgjegjja: i bëjnë jo vetëm për shkak se u mungon edukata por më shumë për shkak se mendojnë që ne mahnitemi (pozitivisht) me ta. Pra, do të fascinohej se sa afër janë ata me udhëheqësit e superfuqive të botës. Këta udhëheqës tanë me siguri nuk e dijnë që këto momente ne i shikojmë me turp duke u munduar të fshihemi nën tavolinë para televizorit. Kur flasim për turpin por edhe për momente tjera të pavolitshme, njerëzit duhet të sjellin shembuj apo përvoja nga jeta e tyre. Unë, një herë jam ballafaquar me turpin. Më poshtë po ua rrëfej një rast kur unë jam turpëruar për shkak se nuk kam dijtë se si të vishem ose kur jam veshur sikur Edi Rama", shkruan në FB, publicisti nga Londra, Daut Dauti.

ANTON ÇETTA ME SHTATORE

"Anton Çetta është një prej figurave më frymëzuese dhe emancipuese në Kosovë e më gjerë.

Si i tillë, diskutimi për shtatoren duhet të jetë i kufizuar vetëm në gjetjen e vendit më të dinjitetshëm, jo vetëm si respekt për veprën, por edhe si shpërndarje e frymës së emancipimit, mobilizimit dhe ballafaqimit me problemet shoqërore në Kosovë që ka frymëzuar Çetta.

Si Komunë, gjatë javëve në vijim do të shqyrtojmë e propozojmë lokacionet për shtatoren", ka shkruar në profilin e tij në Facebook, kryetari i Qytetit të Prishtinës, Shpend Ahmeti.

NËSE NUK E KENI DITUR...

KU NDODHET ZADRIMA?

Zadrime (Fusha e Tejdrintit) është fushë në Ultësirën Bregdetare, pjesë e fushës së Nënshkodrës, në rrethin e Lezhës. Shtrihet midis Drinit të Lezhës në perëndim dhe malit të Hajmelit dhe atij të Velës në lindje. Është një fushë e

sheshtë dhe shumë e ulët (20-25 m mbi det). Midis saj ngrihen kodra të ulëta flishore me lartësi 80-100 m. Përshkohet nga lumi Gjadër. Qendrat kryesore të Zadrimes janë: Gjadri, Dajçi, Pistuli, Shkezi, Mjeda etj.

Maqedonia pritet të avancojë legjislaionin që prek fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Buxhet më të madh për ushtrinë, sidomos në pajisjet ushtarake dhe blerjen e armëve moderne, si dhe asimilimin apo zhdukjen e armëve të vjetra njëjtë siç ka bërë Shqipëria dhe shtete tjera të rajonit. Anëtarësimi në NATO do ti kushtojë Maqedonisë dhe kontribut financiar deri në 2 për qind të Bruto Prodhimit Vendor

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 13 korrik - Pas marrjes së ftesës për anëtarësim në NATO, në vend pritet të ketë zhvillime dinamike politike. Së pari, sfida do të jetë zgjedhja e anëtarëve të rinj të KSHZ-së, të cilat detyrë parësore do ta kenë mbajtjen e Referendumit për Marrëveshjen e emrit me Greqinë. Sipas asaj që ka deklaruar kryeministri Zoran Zaev, debati lidhur me referendumin dhe të gjitha çështjet lidhur me të, mes të cilave edhe formimi i KSHZ-së, do të fillojë nga fundi i këtij muaji. "Së pari duhet pasur kujdes për momentin e përpilimit të KSHZ-së. Përbërja e KSHZ-së nuk ka dhe as nuk duhet të ketë kurrfarë lidhje me mbajtjen e referendunit. Ajo është pyetje logjike, e cila erdhi pas dorëheqjeve të anëtarëve të KSHZ-së", tha Zaevi. Ai përkujtoi se me opozitën është dakorduar që VMRO të kryesojë me KSHZ-në, ndërsa partitë e shumicës në pushtet të kenë katër anëtarë - shumicën.

"Shpreh bindjen se këto ditë, ekipet negociuese do të arrijnë t'i harmonizojnë qëndrimet dhe se nuk do të ketë kushte që do të implikojnë bllokim të referendunit të ardhshëm. Pres formim të shpejtë të KSHZ-së", tha kryeministri. Ai vuri theksin se KSHZ duhet të zgjidhet menjëherë, sepse siç shtoi Zoran Zaev, ky është obligim i Parlamentit dhe i të gjithë faktorëve politik në shtet. Sipas tij, në periudhën në vijim do të debatohet edhe për datën e referendunit, çështjen e referendunit, si dhe karakterin e tij.

"Qytetarët kanë të drejtë dhe duhet të deklarohen në referendum", tha Zaevi, duke cekur se ka referendume me peshë të ndryshme, por ky ka rëndësi historike, sepse me të do të definohet e ardhmja drejt së cilës synon vendi ynë. Në pyetjen nëse deri në fund të vitit pret që të ketë 80 deputetë, të cilët do t'i zbatonin ndryshimet kushtetuese, Zaevi theksoi se ai nuk është qëllim i shumicës në pushtet. "Besoj se Parlamenti duhet të sigurojë 120 deputetë, nëse vullneti i qytetarëve do të jetë pozitiv në referendum", theksoi Zaevi, duke shprehur optimizëm se deklarimi i qytetarëve do të jetë pozitiv dhe se shumica e

QEVERIA DHE ANALISTËT KËRKOJNË KYÇJEN EDHE TË OPOZITËS

SHUMË DETYRA DERI TE ANËTARËSIMI I PLOTË



madhe do ta mbështesë të ardhmen e vendit drejt BE-së dhe NATO-s. Nëse grupet e punës nuk arrijnë të dakordohen, kryeministri si mundësi përmendi takimin e liderëve, por, megjithatë shprehu bindje se të gjitha çështjet do të dakordohen në nivel të grupeve punuese.

FTESA NË NJË MOMENT TË VEÇANTË POLITIK TË NATO-S

Ndërkaq, nga bashkësia ndërkombëtare përsëri vënë theksin se në momentin politik të NATO-s me konfrontime publike mes presidentit të SHBA-ve, Donald Trump dhe liderëve të shteteve Perëndimore, për Maqedonisë ishte një vendim i një rëndësi të madhe të merr ftesë për anëtarësim. Zëvendëskryetari i Këshillit Atlantik në SHBA, Deimon Vilson për Radion Europa e Lirë thotë se Samiti i NATO-s do të jetë një shenjë pozitive për votuesit në Maqedoni. Vilson shprehet se qytetarët duhet të sjellin një vendim të madh i cili është shumë e vështirë, por që mund të zhbllokojë anëtarësimin për në NATO si dhe BE. "Ky ishte një Samit i vështirë. Të gjithë e dëgjojnë presidentin Trump, e dëgjojnë retorikën e tij dhe janë të shqetësuar. Kishte reagime të ashpra. Mendoj se vendimi për Maqedoninë ishte shumë i rëndësishëm. Patëm lajme të shkëlqyera. Këto janë lajme historike, këto janë lajmet pozitive nga Samiti, anëtarët e Aleancës bashkë vendosën të mbajnë fjalën nga viti 2008, gjegjësisht nëse ka marrëveshje me Athinën, Shkupi do të marrë ftesë për anëtarësim. Kjo edhe ndodhi", u shpreh mes tjerash Villson.

ERËNDËSISHME KYÇJA E OPOZITËS

Ndërkaq, sipas analistit politik Ibrahim Mehmeti, s'ka dyshim se parakushti kryesor që të mund të realizohet ftesa për anëtarësim në NATO është implementimi i marrë-

29 ANËTARËT E NATO-S

Shqipëria, Belgjika, Bullgaria, Kanadaja, Kroacia, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Franca, Gjermania, Greqia, Hungaria, Islanda, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Mali i Zi, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanjë, Turqi, Mbretëria e Bashkuar, Shtetet e Bashkuara. Shteteve anëtare u kërkohet të bëjnë pagesa për mirëmbajtjen ushtarake në NATO-s. Por janë vetëm katër shtete anëtare të cilat aktualisht po përmbushin udhëzimet e sugjeruara prej dy përqindësh. Këto vende janë Shtetet e Bashkuara me 3.7 për qind, Greqia me 2.36 për qind, Britania e Madhe me 2.12 për qind dhe Estonia me 2.08 për qind. Shqipëria është e shtata nga fundi dhe shpenzon vetëm 1.10 për qind të GDP-së për mbrojtjen.

veshjes për çështjen e emrit ndërmjet Shkupit dhe Athinës. "Kuptohet se kjo nuk do të thotë se nuk janë të rëndësishme edhe pikat tjera, para se gjithash ato që kanë të bëjnë me qeverisjen e mirë dhe pushtetin e së drejtës. Vetë ftesa nga NATO flet se pikat tjera, përveç asaj të emrit, nuk vihen në dyshim, sepse Qeveria aktuale në një vit të ushtrimit të pushtetit dëshmoi se ka vullnet që t'i përmbushë kërkesat që vijnë nga anëtarësimi në NATO, mirëpo implementimi i marrëveshjes me Athinën kërkon kyçjen edhe të opozitës, gjë që mund ta komplikojë këtë proces", thotë Ibrahim, duke i dhënë kahje serioze kyçjes së opozitës në procesin për implementimin e Marrëveshjes së emrit. Sidoqoftë, shton ai, në momentin kur qeveria ta gjejë mënyrën e kyçjes së opozitës në realizimin e marrëveshjes për emrin, gjithçka tjetër do të jetë vetëm çështje teknike. "Ne periudhën që vijon mbetet të shohim se a do të gjejë Qeveria forcë ta bëjë këtë, ose përsëri do të ketë nevojë për ndihme nga diplomacia e shteteve mike të Maqedonisë në bindjen e opozitës së NATO nuk është interes i Qeverisë, por i gjithë qytetarëve, përfshi edhe votuesit e saj", ka vënë theksin Ibrahim Mehmeti.

Ndërkaq, ministrja e Mbrojtjes, Radmilla Sheqerinska ka thënë se Armata e Republikës së Maqedonisë është gati për në NATO. "Armata

e Republikës së Maqedonisë është e përgatitur për NATO, por mungon sistemi adekuat i shtetit", mendon Sheqerinska, e cila theksoi se anëtarësimi në NATO është vetëm njëra pjesë e integritetit të Maqedonisë në strukturat ndërkombëtare. Ajo tha se anëtarësimi në NATO do të ndihmojë edhe anëtarësimin në BE. Duke folur për sfidat e anëtarësimin në aleancë, Sheqerinska theksoi se mirëmbajtja e ARM-së kushton dhe për këtë arsye - edhe është rritur buxheti për 15 për qind. "Në ndërkohë, punët nuk kanë mbetur në pikën e njëjtë, janë përkeqësuar dhe kjo është e qartë për të gjithë. Sigurimi i forcave tuaja ushtarake kushton dhe pa marrë parasysh a jemi anëtare e NATO-s ne duhet të mirëmbajmë të financojmë dhe të furnizojmë armatën dhe kjo nuk është punë e lehtë në asnjë vend. Sipas pjesëmarrjes tonë në misionet ndërkombëtare, sidomos në NATO forcat tona ushtarake janë të përgatitura, sistemi duhet të jetë më i mirë", tha Sheqerinska.

SHUMË DETYRA DERI NË ANËTARËSIM TË PLOTË

Pas përfundimit të negociatave për inkuadrim, do të nënshkruhet Protokoll për inkuadrim, i cili pastaj duhet të ratifikohet nga Parlamentet e të gjithë vendeve-anëtare të NATO-s. Ky proces i ratifikimit është ai i cili merr më shumë kohë. "Ajo që merr kohë është në fakt ratifiki-

mi në vendet e ndryshme anëtare", ka shpjeguar ditë më parë njeriu i parë i NATO-s, Jens Stoltenberg. Shqipëria dhe Kroacia, madje u ftuan në prill të vitit 2008, ndërsa u inkuadruan në prill të vitit 2009, një vit më vonë. Ndryshe, NATO do ti jep Maqedonisë doracak me punë për anëtarësim. Javën e ardhshme do të fillojë procedura paraaduese. Në periudhën prej 4-6 muaj do të ketë procedurë të brendshme në Maqedoni, ku pas ratifikimit të marrëveshjes për emrin me Greqinë, në vjeshtë do të mbahet referendumi dhe ndryshimi i Kushtetutës së Maqedonisë. Nëse bisedimet rrjedhin sipas planit, ato do të përmbyllen deri në janar të vitit 2019. Pas ratifikimit të Marrëveshjes në Parlamentin e Greqisë, në një periudhë njëvjeçare, pason ratifikimi i anëtarësimin të Maqedonisë në NATO nga të gjitha parlamentet e vendeve anëtare të Aleancës Veri-Atlantike. Në rast se referendumi dështon, me automatizëm dështon edhe marrëveshja. Në rast se referendumi kalon, atëherë nevojiten ndryshimet kushtetuese për të cilat nevojiten dy të tretat e votave në Parlament për të ndryshuar pjesët që kanë të bëjnë me emrin e shtetit dhe termet "maqedonase" dhe "maqedon". Marrëveshja, gjithashtu nuk do të jetë e përfundimtare pa kaluar edhe në Parlamentin e Greqisë. Ndryshe, Maqedonia prite të avancojë legjislaionin që prek fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Buxhet më të madh për ushtrinë, sidomos në pajisjet ushtarake dhe blerjen e armëve moderne, si dhe asimilimin apo zhdukjen e armëve të vjetra njëjtë siç ka bërë Shqipëria dhe shtete tjera të rajonit. Anëtarësimi në NATO do ti kushtojë Maqedonisë dhe kontribut financiar deri në 2 për qind të Bruto Prodhimit Vendor. Pakti NATO u themelua më 4 prill 1949, kur u nënshkrua Traktati i Atlantikut të Veriut në Uashington DC. Anëtarët themelues të NATO-s ishin SHBA, Franca, Britania e Madhe, Belgjika, Kanadaja, Danimarka, Islanda, Luksemburgu, Italia, Holanda, Norvegjia dhe Portugalia. NATO u themelua në mënyrë që të krijonte një sistem të mbrojtjes së ndërsjellë nga një sulm i jashtëm. Neni 5 i Traktatit të Atlantikut të Veriut kërkon që shtetet anëtare të pavarura të vijnë në mbrojtje të çdo shteti anëtar, nëse ndodh një sulm nga një palë e jashtme. Kjo është vënë në zbatim të vetmen herë pas sulmit terrorist të 11 shtatorit.

“VITI I GJERGJIT” NË MAQEDONI KULMON MË 22 NËNTOR

DITA E ALFABETIT, NË SHKUP APO MANASTIR

Ngjarjet kryesore parashikohen të zhvendosen këtë vit në Shkup, ndërsa në Manastir manifestimet do të zhvillohen gjatë një jave, ditëve kur ka nisur dhe është mbyllur Kongresi. Nga Muzeu i Alfabetit apelojnë që në përvjetorë të tillë - qytetit ku u mbajt Kongresi, duhet t'i jepet rëndësia që e meriton



Koha Evis HALILI

Shkup, 13 korrik - Kryeqendra e aktiviteteve me rastin e 110 vjetorit të Ditës së Alfabetit do të jetë Shkupi. Ngjarjet kryesore parashikohen të zhvendosen këtë vit në Shkup, ndërsa në Manastir manifestimet do të zhvillohen gjatë një jave, ditëve kur ka nisur dhe është mbyllur kongresi. Në Sekretariatit për Implementimin e Marrëveshjes së Ohrit, ku prej disa vitesh kujdesen për organizimin e kësaj date, janë duke bërë gati programin për këtë ditë, që duhet të miratohet nga Qeveria.

Gjasat janë që këtë vit, Parla-

menti të jetë një prej destinacioneve ku do të zhvillohen një pjesë e aktiviteteve. Disa muaj më parë, nën patronazhin e kreut të Parlamentit, Talat Xhaferi u ngrit një Këshill i posaçëm, i angazhuar për të hartuar kalendarin e aktiviteteve me të cilat Maqedonia i bashkëngjitet ftesës për shënimet mbarëkombëtare. Ndërsa në Manastir shënimet zgjasin një javë. Nga Muzeu i Alfabetit apelojnë që në përvjetorë të tillë qytetit ku u mbajt Kongresi duhet t'i jepet rëndësia që e meriton.

“Ne jemi duke u përgatitur për

të shënuar këtë datë me aktivitete që do të zgjasin nga 12-22 nëntor. Përveç Akademisë së Solemne, konferencave, do të ketë edhe manifestimeve me karakter artistik, si ekspozita, koloni, koncerte. Gjithsesi mendoj se kjo datë duhet që si pikë kryesore duhet të ketë Manastirin. Viteve të kaluara ishte traditë që vëmendja të përqendrohej në Shkup, por është mirë që Manastiri të mos rrijë në hije. Është e drejtë e shqiptarëve të festojnë në çdo qytet, por manifestimi kryesor duhet të mbahet këtu, në Manastir”, thotë drejtori Nuer Arslani. Edhe Institu-

ti i Trashëgimisë është pjesë e aktiviteteve për 22 nëntorin, por edhe të Vitit të Gjergjit.

Drejtori i ITSHKSH dhe zëvendëskryetar i Këshillit, Skënder Asani, thotë se instituti është bartës i aktiviteteve që janë zhvilluar deri tani dhe do të vijojnë deri në fund të vitit. Sipas Hasanit, krahasuar me Shqipërinë apo Kosovën, shqiptarët në Maqedoni kanë arritur të kenë aktivitete shumë ambicioze, siç është promovimi i librit për Skënderbeun, Java e Kulturës shqiptare, dokumente të pabotuara për familjet katolike në kuadër të 90 vjetorit të largimit të Nënë Terzës nga Shkupi, e të tjera.

“Në Parlament do të zhvillohet një ceremoni solemne, këtë vit kemi përputhje mes këtij përvjetori, por edhe ngjarjeve të tjera të rëndësishme për ne shqiptarët, si ligji për gjuhën shqipe. Ne si Këshill jemi duke vazhduar me realizimin e programit të parashikuar, që deri në fund të vitit do të ketë edhe shumë ngjarje të tjera interesante”, thotë zëvendëskryetari i Këshillit, Asani. Edhe pse “Viti i Skënderbeut” u shpall si një vit i aktiviteteve mbarëshqiptare, koordinimi mes tre vendeve për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta ka qenë i vogël. Në Maqedoni Viti i Gjergjit



NUER ARSLANI

Ne jemi duke u përgatitur për të shënuar këtë datë me aktivitete që do të zgjasin nga 12-22 nëntor. Përveç Akademisë së Solemne, konferencave, do të ketë edhe manifestimeve me karakter artistik, si ekspozita, koloni, koncerte. Gjithsesi mendoj se kjo datë duhet që si pikë kryesore duhet të ketë Manastirin. Viteve të kaluara ishte traditë që vëmendja të përqendrohej në Shkup, por është mirë që Manastiri të mos rrijë në hije



SKENDER ASANI

Në Parlament do të zhvillohet një ceremoni solemne, këtë vit kemi përputhje mes këtij përvjetori, por edhe ngjarjeve të tjera të rëndësishme për ne shqiptarët, si ligji për gjuhën shqipe. Ne si Këshill jemi duke vazhduar me realizimin e programit të parashikuar, që deri në fund të vitit do të ketë edhe shumë ngjarje të tjera interesante

nisi më 17 janar, me shënimin e përvjetorit të 550 të vdekjes së Skënderbeut dhe promovimin e pullës postare me imazhin e heroit kombëtar.

MBËSHTETJE TË PLOTË PËR FILLIMIN E NEGOCIATAVE

Parlamenti Evropian e përshëndeti edhe miratimin e Ligjit për gjuhët, por kritikoi taktikat që kanë për qëllim minimin e miratimit të Ligjit në përputhje me procedurat

Bruksel, 13 korrik - Projekt-raporti i Parlamentit Evropian për Maqedoninë jep mbështetje të plotë për fillimin e negociatave me BE-në në qershor të vitit 2019. Për raportin e PE-së do të votohet në nëntor. “PE-ja e mbështet plotësisht rekomandimin e Komisionit Evropian dhe vendimin e Këshillit të vendoset qershori i vitit 2019 si datë për fillimin e negociatave si mirënjohje për përpjekjet inkurajuese reformuese, beson se hapja e shpejtë e procesit skringing dhe negociatave inkuadruare do të ruajë dhe thellojë momentin reformues, vlerëson se hapja e negociatave do të sillte stimulim shtesë për demokratizimin, dhe do ta forconte mbikë-

PE kritika Ivanovit për bllokimin e Ligjit të shqipes



qyrjen dhe llogaridhënien”, qëndron në draft-raportin e Parlamentit Evropian për Maqedoninë. Raporti, të cilin e ka shkruar raportuesi për Maqedoninë, Ivo Vajgël, i përshëndet marrëveshjet për fqinjësi të mirë me Greqinë dhe Bullgarinë dhe u bën thirrje autoriteteve t'i informojnë qytetarët e tyre për përmbajtjen dhe implikimet e marrëveshjes me Greqinë, si dhe në mënyrë të ndërgjegjshme

t'i përmbushin të gjitha procedurat e brendshme për ratifikimin dhe zbatimin e marrëveshjes. Dokumenti i bën thirrje Parlamentit të Maqedonisë “t'i përdorë plotësisht funksionet e tij mbikëqyrëse dhe ligjvënësë” dhe ta kufizojë përdorimin e procedurave urgjente, dhe u rekomandon partive politike të vendit t'i demokratizojnë procedurat e tyre të brendshme të vendim-marrjes. Ashtu si në raportin e Ko-

misionit Evropian, edhe vendimi i Këshillit për fillim të negociatave, kritikën më të mëdha kanë të bëjnë me sundimin e ligjit në Maqedoni. Raporti përkujton se korrupsioni në vend mbetet i përhapur dhe kërkon rezultate të qëndrueshme në rastet e lidhura me korrupsionin e lartë dhe krimin e organizuar, dhe e përshëndet punën e PPS-së në “kushte të vështira”. PE pret edhe llogaridhënie në lidhje me bisedat e përgjuara dhe kërkon nga Parlamenti t'i rrumbullaksojë reformat e shërbimeve të inteligjencës dhe të sigurojë mbikëqyrje adekuate ndaj tyre. Maqedonia, sipas PE-së, duhet të përmirësojë menaxhimin me sistemet e azilit dhe migrimit dhe ta rrisë bashkëpunimin me Agjencinë Evropiane Fronteks. PE e përshëndeti edhe miratimin e Ligjit për gjuhët, por kritikoi taktikat që kanë për qëllim minimin e miratimit të Ligjit në përputhje me procedurat. Raporti vlerëson se

përmirësimet në sferën e mediave dhe raportimi i pavarur janë modest, por e përshëndeti heqjen e reklamave qeveritare në media si masë e rëndësishme. “PE bën thirrje për mbrojtje shtesë kundër partizimit të mediave, e thekson nevojën që të përforcohet pavarësia dhe kapacitetet e rregullatorit medial dhe shërbimit publik, bën thirrje për masa për rritjen e mbrojtjes së të drejtave të punëtorëve dhe të drejtave sociale të gazetarëve”, qëndron në raport. Parlamenti Evropian kërkon edhe të ketë hetime për kërcënimet dhe frikësimet e gazetarëve dhe dënon çdo lloj gjuhe urrejtjeje dhe retorike populiste. Deputetët evropianë për këtë raport fillimisht duhet të votojnë në nivel të komitetit në fillim të nëntorit, ndërsa në seancë plenare në nëntor. Raportuesi Ivo Vajgël do ta vizitojë Shkupin të hënën dhe të martën javën e ardhshme.

Ngjashëm si në GJPSH-ë, grupi punues i Ministrisë së Drejtësisë, i udhëhequr nga gjykatësit Llazar Nanev dhe Zoran Dimitrievski, ka konstatuar se në Gjykatën Supreme, gjatë kohës së kryetares Lidija Petrovska dhe atij aktual, Jovo Vangelovski, shumë procedura nuk kanë qenë të standardizuara

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 13 korrik - Sistemi elektronik i ndarjes së lëndëve në Gjykatën Penale të Shkupit (GJPSH) dhe Gjykatën Supreme, në masë të madhe nuk ka funksionuar në formën e duhur. Ndonëse i vonuar, Ministria e Drejtësisë ditë më parë e publikoi Raportin e Grupit të punës, i cili gjatë vitit të kaluar realizoi kontroll mbi AKMIS-in në gjykatat e apostrofuara. Të dhënat e siguruar nga Grupi i punës i Ministrisë së Drejtësisë, kanë konstatuar se përveç në vitin 2013, në GJPSH, nuk është realizuar plan vjetor për menaxhimin dhe zvogëlimin e lëndëve të pazgjidhura. Për këtë arsye, siç thuhet në Raportin e AKMIS-sistemit, deri me 26 tetor të vitit të kaluar nuk janë zgjidhur rreth 860 lëndë. Gjatë takimit me Grupin e punës të Ministrisë së Drejtësisë, ushtruesi i detyrës së asaj kohe kur është realizuar kontrolli mbi "AKMISIN", në GJPSH-ë, Stojançe Ribarev, ka pranuar se një numër i konsiderueshëm i lëndëve në këtë gjykatë janë ndarë "dorë më dorë", respektivisht ai këtë mënyrë të punës e ka emërtuar si "AKMIS i dyfishtë".

"Me 3 korrik të vitit të kaluar, u.d kryetar i GJPSH-së, Stojançe Ribarev, ka formuar grup pune për menaxhim të lëndëve në atë Gjykatë.

AKMIS I DYFISHTË NË GJPSH

LËNDËT GJYQËSORE JANË NDARË "DORË MË DORË"



Paraprakisht nuk ka ekzistuar një grup i tillë. Megjithatë edhe pasi Ribarev e ka formuar këtë lloj komisioni, nuk është përgatitur Plani vjetor për menaxhimin e lëndëve, dhe aq më pak janë miratuar procedurat e brendshme", thuhet në Raportin e AKMIS-sistemit.

Shkelje tjetër e rëndë, të cilën e ka vërtetuar ekipi i Ministrisë së Drejtësisë, në GJPSH-ë, është mos respektimi i procedurës për miratimin e Sistematizimit vjetor të gjykatës, i cili gjatë asaj periudhe siç edhe dihet shpesh herë është ndryshuar. Si rezultat i këtyre shkeljeve është vërtetuar se lëndë të caktuar gjyqësore shpesh herë janë transferuar nga njëri te tjetri gjykatës përmes parimit "dorë më dorë". Njëkohësisht, për këtë arsye është kufizuar edhe numri i gjykatës të cilëve në mënyrë elektronike u janë dhënë lëndët. AKMIS-sistemi, sipas të dhënave të Ministrisë së Drejtësisë, nuk është shfrytëzuar as

në ndarjen e lëndëve të gjykatës në procedurë paraprake apo të këshillave penale nga Sektori për krim të organizuar, ku janë parashtruar rastet e Prokurorisë Speciale Publike.

Ky grup i punës ka në Raportin e përgatitur dhe dorëzuar drejtuesve të Ministrisë së Drejtësisë, rekomandon që të merren masa për përfortimin e kontrollove. Parregullsitë dhe veprimet jo ligjore me "AKMIS"-sistem, në GJPSH-ë, po ashtu janë kryer edhe gjatë kohës kur me këtë gjykatës ka udhëhequr kryetari Vladimир Pançevski dhe ushtruesi i detyrës, gjykatësja Tatjana Mihajlova.

Ngjashëm si në GJPSH-ë, grupi punues i Ministrisë së Drejtësisë, i udhëhequr nga gjykatësit Llazar Nanev dhe Zoran Dimitrievski, ka konstatuar se në Gjykatën Supreme, gjatë kohës së kryetares Lidija Petrovska dhe atij aktual, Jovo Vangelovski, shumë procedura nuk kanë qenë të standardizuara. Aq më

pak siç thuhet në Raport, nuk ka qenë e avancuar procedura e "AKMIS", në të gjitha gjykatat. Pas largimit të Nedellkovës nga kreu i Gjykatës Supreme, shpesh herë është ndryshuar sistematizimi i gjykatës në këtë gjykatë, me çka nuk është mbajtur llogari për nivelin e specializimit të tyre. Kështu gjykatësit e sferës penale janë caktuar të shqyrtojnë lëndë civile apo në janë caktuar të procedojnë raste-lënda e të cilëve ka qenë e lidhur me kohën e miratimit të vendimeve dhe anashjelltas. Sistematizimi i gjykatësve në Gjykatën e Lartë të Maqedonisë vetëm gjatë 2017 është ndryshuar nëntë herë radhazi, për të cilën kryetari i Këshillit Gjyqësor deklaroi se nuk ka vërejtur asnjë veprim të kundërligjshëm në këtë gjykatë. Ndryshe, menjëherë pas përgatitjes së këtij raporti lëndë i është dorëzuar Prokurorisë Publike e cila deri më sot ende nuk është prononcuar për rrjedhën e hetimeve.

KRONIKË

Dhjetë persona sulmojnë dy tetovarë

Në orët e hershme të mëngjesit të ditës së premte, personi me iniciale me iniciale D.P. 26-vjeçar nga Tetova, ka denoncuar se në rrugën "Lubo Bozhinovski Pish" në Tetovë, së bashku me shokun e tij B.D. 19-vjeçar, janë sulmuar fizikisht nga ana e dhjetëra personave të panjohur. Paraprakisht, sulmuesit me dy vetura dhe një motoçikletë janë ndaluar në vendin në të cilin kanë qëndruar të ulur B.D. me shokun e tij dhe disa persona tjerë, sulmuesit kanë dalë nga veturat dhe me shkopinj bejsbolli si dhe mjete tjera të forta, kanë filluar të vrapojnë pas tyre. Gjatë ikjes, ata kanë hyrë në një oborr të një shpie aty afër, ku sulmuesit i kanë arritur dhe kanë filluar ta sulmojnë personin D.P. në pjesën e kokës dhe trupit, duke i shkaktuar lëndime të dukshme, ndërsa më pas - sulmuesit janë larguar, ndërsa të lënduarit D.P. ndihmë mjekësore i është dhënë në Spitalin Klinik të Tetovës. Merren të gjitha masat dhe aktivitetet për zbardhjen e plotë të rastit, gjetjen dhe identifikimin e sulmuesve.

Gostivar, një qytetar e harron pistoletën në spital

Të enjten rreth orës 16 e 20 minuta, në tualetin për femra, në spitalin e përgjithshëm "Ferid Murat" në Gostivar është gjetur armë zjarri-pistoletë "Crvena Zastava M-57" e kalibrit 7.62 milimetër, me 8 plumba si dhe tre bankënota në euro dhe denarë. Menjëherë është vërtetuar se pistoletë është pronë e 68-vjeçarit I.S. nga fshati Turčan i Vogël, të cilën e ka poseduar me leje, dhe sipas tregimit të tij, e ka harruar në atë vend. Janë kryer hetimet dhe rasti është duke u zbardhur. (U.H)

LETËR ME KËRCËNIME E FIRMOSUR NGA PATRIARKU SERB, IRINEJ

SHKAK KOM-I, KISHA SERBE KËRCËNON KISHËN BULLGARE

Shkup, 13 korrik - Kisha Ortodokse Serbe ka kundërshtuar dhe kërcënuar Kishën Ortodokse Bullgare, e cila së fundmi është zotuar për ta ndihmuar Kishën e Maqedonisë që të fitojë statusin kanonik të KOM-it në botë. Në një letër drejtuar Kishës Bullgare, patriarku serb Irinej ka përdorur shprehje ofenduese dhe kërcënuese, si ndaj patriarkut bullgar Neofit, ashtu edhe ndaj Kishës Ortodokse Maqedonase - Arkipeshkvisë së Ohrit. Në letër të firmosur nga Irinej, Kisha Serbe i kërkon asaj Bullgare të ndërpret bashkëpunimin me KOM-Arkipeshkvinë e Ohrit, pasi e njëjta siç shkruan në letër, nuk i përmbush kushtet për të qenë e njohur, si dhe kërcënon për ndërprerje të bashkëpunimit me Kishën Bullgare nëse



vazhdon ndihma për zgjidhjen e statusit të Kishës Maqedonase. Letra e Irinejit në adresë të Kishës Bullgare dhe asaj Maqedonisë është dërguar më 17 prill, ndërsa deri tani, e njëjta nuk ishte pu-

blikuar. Gjithçka kishte filluar në vjeshtën e kaluar, kur Kisha Ortodokse Maqedonase - Arkipeshkvia e Ohrit i kishte kërkuar Kishës Ortodokse Bullgare ndihmë për zgjedhjen e statusit të saj kanonik

dhe ajo të jetë Kisha e saj amë, ndryshe nga seç ishte deri tani Kisha Serbe. Në fund të muajit nëntor, Shën Sinodi i KOB-it kishte formuar Komision të posaçëm për zgjidhje të statusit të KOB të udhëhequr nga Mitropoliti Kiriprijan. Në fillim të muajit janar, në Shën Sinodin e KOB u mbajt takimi me arkëpeshkopin Stefan - kreun e KOM-AO dhe disa mitropolitë tjerë. Gjatë Pashkëve, Bullgaria gjithashtu i dhuroi flakë të bekuar Maqedonisë të cilën për herë të parë e pranoi zyrtarisht. Kjo ishte edhe arsyeja pse Kisha Serbe po reflekton nervozë dhe kundërshti, pasi nën ingerencat e Kishës Bullgare, Kisha Maqedonase më lehtë do t'i fitojë njohjet e kishave tjera në botë.

Kompania në fillim do t'i investojë katër milionë euro me punësimin e 300 personave, ndërsa në plan afatgjatë është investim prej 11 milionë eurosh dhe 600 punësime

EDHE NJË INVESTIM I HUAJ NË MAQEDONI

"TELAMONI" VJEN ME 11 MILIONË DOLLARË

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 13 korrik - Kompania multinacionale "Telamon" nga SHBA dhe e firmosi marrëveshjen për realizimin e investimit të saj në Maqedoni e cila do të arrijnë deri në 11 milionë euro. Do t'i punësojë 600 persona, ndërsa do të prodhojë kablllo elektrike për industrinë automobilistike. Planifikon bashkëpunim shumëvjeçar, ndërsa Maqedoninë e kanë zgjedhur nga shumë vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore për ta zgjeruar prodhimin e saj nga SHBA-ja në Evropë. Marrëveshjen e nënshkruan ministrja për Tërheqjen e Investimeve të Huaja, Zorica Apostolovska dhe drejtori i "Telamon", Tom Puza. Në nënshkrimin e marrëveshjes morën pjesë kryeministri Zoran Zaev dhe zëvendëskryeministri për Çështje Ekonomike, Koço Angjushev. "Mbesim të përkushtuar në krijimin e klimës të favorshme dhe atraktive të biznesit për të njohur Maqedoninë si destinacion i qëndrueshëm afatgjatë i biznesit që siguron edhe qëndrueshmëri të investimit dhe kapitalit të tyre", tha kryeministri Zaev. Ai shtoi se ftesën të cilën e kemi fituar për fillimin e bisedimeve për anëtarësim në NATO tha se edhe më shumë do ta përforcojë këtë pozicion të Maqedonisë si destinacion i dëshiruar dhe i qëndrueshëm. "Qytetarët do ta përkrahin anëtarësimin tonë në BE dhe NATO sepse e din se përfitimet janë të mëdha, kanë një qëllim për përmirësimin e jetës të të gjithëve", tha Zaev. Sipas



zëvendëskryeministrit Angjushev zgjedhja e "Telamon" për të zgjeruar prodhimtarin e vet në Maqedoni tregon se vendi është konkurrent në politikën e saj në përkrahjen investimeve të huaja direkte. "Kompanitë e tilla e njohin Maqedoninë si vend për zhvillim të biznesit të mëtejshëm të tyre dhe strategjisë si kompani. Kjo na nxit që ne t'i zhvillojmë politikat tona ekonomike dhe na tregojnë se jemi në rrugë të drejtë për të zbatuar atë që e kemi menduar", tha Angjushev dhe shtoi se përfaqësues të kompanisë kanë ardhur vetëm para gjashtë muajve dhe se në Qeveria me përkushtim është punuar në krijimin e kushteve që ajo të fillojë me aktivitetet e saja. Për ministren Apostoloska nënshkrimi i Marrëveshjes është vërtetim i politikave të suksesshme ekonomike të Qeverisë në pjesë të investimeve të huaja. Kompania në fillim do

t'i investojë katër milionë euro me punësimin e 300 personave, ndërsa në plan afatgjatë është investim prej 11 milionë eurosh dhe 600 punësime. Drejtori i "Telamon", Tom Puza theksoi se deri në fund të vitit pret të ketë 50 të punësuar, tanimë janë bërë punësimet e para, ndërsa prodhimet e para deri tek konsumatorët do të shpërndahen deri në vjeshtë. Ai thotë se si kompani amerikane fillimet e funksionimit në Evropë janë sfida e madhe dhe se është e rëndësishme ndihma të cilën e fitojnë këtu. Qëllimi i kompanisë, thotë, është gjithëpërfshirës dhe ka për qëllim të ketë ndikim pozitiv ndaj të gjitha palëve të prekura dhe gjithashtu është i interesuar për bashkëpunim afatgjatë. Kompania punon në Meksiko, Kinë dhe në SHBA ku ka zyra përfaqësimi në nëntë vende. Kjo është fabrika e parë në Evropë.



Dëshmitarë të rinj kundër Gruevskit e Janakieskit

Shkup, 13 korrik - Me dëgjimin e dëshmitarëve, gjykimi për lëndën "Dhuna në Komunën Qendër" të PSP-së do të vazhdojë më 30 gusht. Në seancën e djeshme, në të cilët të akuzuar janë ish-kryeministri Nikolla Gruevski, ish-ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Mile Janakieski, këshilltarja e VMRO-DPMNE-së në atë kohë, Daniella Rangellova dhe disa të tjerë të cilët ishin pjesë e turmës e cila më 10 qershor të vitit 2013 protestoi para Komunës Qendër, u dëgjuan dy ish-këshilltarë të Komunës Qendër nga koalicioni i kryesuar nga LSDM. Jovan Tagasovski dhe Darko Gigoski dëshmuar për momentet kur në mbledhjen e Këshillit të Komunës Qendër hynë disa qytetarë të cilët, sipas tyre, kishin për qëllim ta ndërpresin mbledhjen. Dëshmitari Tagasovski i pyetur për ngjarjet në mbledhjen e Këshillit, tha se i kujtohet se një grup njerëzish me guajtje të gjësendeve të forta i kanë sulmuar këshilltarët prej të cilëve një kolege e tyre ishte lënduar, ndërsa nga ajo që kishte aritur të marrë vesh, tha se ata protestonin për shkak të vendimit për rrënim të kishës "Shën Konstantini dhe Elena" në Qendër. Ai ka tentuar t'u thotë se pikë të tillë në rend dite nuk ka dhe se nuk ekziston kurrfarë rrënimi i kishës. Dëshmitari Gigoski pati pikëpamje të ngjashme për ngjarjen e atëherëshme, por për dallim nga Tagasovski, ai njohur tre në gjykatë të cilët atëherë kishin marrë pjesë në grupin i cili kishte hyrë në mbledhjen e Këshillit të Komunës Qendër. Në fillim të seancës së djeshme i akuzuari Gruevski u vonua pesëmbëdhjetë minuta, ndërsa avokati Dimitar Dangov e njoftoi gjykatësin se ai për një kohë të shkurtër do të arrijë në gjykatë. Prokurorja Fatime Fetaj reagoi dhe kërkoi nga gjykatësi që i akuzuari të sillet me forcë. Pas një kohe të shkurtër, Gruevski arriti dhe u paralajmërua nga gjykatësi për vonesën. (O.XH)

Shabani i sëmurë, "Tenderët" shtyhet për më 25 shtator

Shkup, 13 korrik - Për shkak të sëmundjes së gjykatësit Osman Shabani sot në Gjykatën penale në Shkup nuk u mbajt seanca për lëndën e PSP-së "Tenderët", në të cilën e akuzuar ish-ministrja e Kulturës, Elizabeta Kançeska-Milevska, lidhur me tenderin për kryerje të punëve ndërtimore në Muzeun e luftës maqedonase për shtetësi dhe pavarësi nga projekti "Shkupi 2014". Seanca e re është

caktuar për më 25 shtator, kur do të dëgjohen dëshmitarët e prokurorisë dhe mbrojtjes. Termin i dytë, rezervë për seancë të re është caktuar për më 4 tetor. Në këtë rast të akuzuar janë edhe dy anëtarë të Komisionit për furnizime publike. Sipas prokurorisë, një pjesë e punëve ndërtimore në Muze janë kryer në dobi të personit juridik "Beton" nga Shtipi. Para se të shpallet konkurs për

ndarje të marrëveshjes për furnizim publik dhe para se të zbatohet procedura, në kundërshtim me Ligjin për furnizime publike, Kançeska-Milevska përmes bisedimeve me drejtorin e përgjithshëm të ndërmarrjes ndërtimore "Beton" nga Shtipi ka urdhëruar të vazhdohet me punë në Muze, ku janë kryer punë ndërtimore pas marrëveshjes së lidhur paraprakisht për furnizim publik.

INSTITUTI NDËRKOMBËTAR TË EVROPËS JUGLINDORE

Terapi të reja për trajtimin e kancerit

Shkup, 13 korrik - Instituti Ndërkombëtar i Europës Juglindore për Teknologjinë e Qëndrueshme që merret me hulumtimet terapinë tumorale dhe hulumtimin biomedik, si një nga problemet më shqetësuese të rajonit, është mbledhur në takimin e tretë në Shkup. Puna e këtij instituti parashikon ndërtimin e një sinkrotroni për qëllim biomjekësor, respektivisht trajtimin e kancerit me terapi hadronike. Pas dy takimeve të mbajtura në Bullgari dhe vitin e

kaluar në Shqipëri, ai i radhës në Shkup synon të promovojë bashkëpunimin midis shkencës, teknologjisë dhe industrisë për të mbështetur zhvillimin e inovacionit, shkëmbimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore dhe shkëmbimin e informacionit të dobishëm midis vendeve në rajon. Në takimin e Komitetit Drejtues të INEJL ishin të pranishëm ministrja e Shkencës së Malit të Zi, Sanja Damjanović, ministri i Arsimit dhe Shkencës, Arbër Ademi dhe shumë

përfaqësues të botës akademike dhe shkencore nga vendi dhe jashtë. Instituti do të jetë platformë për edukimin e punonjësve të shkencës bazuar në transferimin e njohurive dhe teknologjive nga laboratorët dhe qendrat evropiane. Aty do të punësohen shkencëtarë dhe ekspertë nga vendet themeluese, mes të cilëve edhe shkencëtarë nga vendi. "Koncepti shkencor, që u miratua dhe ku do të bazohet puna e Institutit, parashikon ndërtimin e një sinkrotroni

për qëllim biomjekësor, trajtimin e kancerit me terapi hadronike. Ky projekt pritet të ketë shkallë të lartë edhe të qëndrueshmërisë, sepse rreth 50 pwr qind të kohës sinkrotroni do të punojë si mjet terapeutik dhe 50 pwr qind për kërkim shkencor, duke e bërë atë unik", ka thënë ministri Ademi. Deklarata e "Themelimit të Institutit Ndërkombëtar të Evropës Juglindore për Teknologji të Qëndrueshme" u nënshkrua në CERN vitin e kaluar. Instituti ka për qëllim

të fuqizojë bashkëpunimin rajonal në kërkimin dhe zhvillimin shkencor dhe teknologjik, bazuar në një strukturë të gjerë që mundëson aktivitete shkencore dhe teknologjike konkurruese ndërkombëtare dhe është një mjet i rëndësishëm për të adresuar sfidat e përbashkëta dhe një instrument i rëndësishëm për nxitjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm teknologjik e shkencor nëpërmjet përpjekjeve dhe angazhimeve të përbashkëta. (E.H.)

FONDI PËR INOVACIONE DHE ZHVILLIM TEKNOLOGJIK

NDAHEN GRANTET PREJ 10.5 MILIONË EURO

Kompanitë përfituese të granteve të pakthyeshme qeveritare që u ndanë të premtën nga ana e Fondit për inovacione, do të hapin 85 vende të reja pune. Njëherësh, 79 kompani të teknologjisë informatike, energjetikës, bujqësisë, shëndetësisë etj, do të punësojnë edhe 85 punëtorë të rinj



vendës kryeministri për çështje ekonomike Koço Angjushev.

Sipas tij, një ndër qëllimet kryesore të planit qeveritar ekonomik është rritja e konkurrencës së ekonomisë vendore ku në çdo një denar të investuar nga ana e kompanive, shteti do të ndihmojë me 1.4 denarë.

Në ndërkohë, kryeministri Zoran Zaev theksoi se shteti në mënyrë të barabartë i ndihmon edhe kompanitë vendore edhe ato të huaja.

"Kompanitë mund ti porosis se qeveria do të jetë servis dhe partner i vërtetë në realizimin e qëllimeve dhe biznes ideve të tyre. Gjithashtu kjo le të jetë edhe një shembull pozitiv që do ti motivojë edhe kompanitë e tjera të krijojnë projekte cilësore dhe të hyjnë në investime", thotë kryeministri Zoran Zaev.

Në ndërkohë, drejtori i Fondit për inovacione dhe zhvillim teknologjik, Jovan Despotovski, gjatë ndarjes së granteve të para theksoi se para dhjetë muajsh kishin edhe drojë, dilema dhe skepticizëm, se sa kompanitë janë të gatshme për thithjen e mjeteve të dedikuara për ide dhe inovacione, ndërsa sot jo vetëm se 79 kompani kanë fituar mjete, por edhe se shpejti do të pu-

blikohen edhe 80 kompani të tjera fituese të granteve, ndërsa shteti do të rrisë edhe fondin për projekte të reja.

"Pas një viti të stabilitetit politik, po realizohen edhe investimet e reja ku ekipet me të vërtetë kanë dhënë maksimumin e tyre në 33 ditë, lidhur me shqyrtimin dhe vlerësimin e projekteve. Gjithashtu 60 për qind e kompanive fituese janë nga Shkupi, ndërsa 40 për qind janë nga qytetet e tjera. Mund të paralajmëroj edhe thirrje të re për grante të reja", theksoi Despotovski.

Ndryshe, mjetet që ndahen për biznesin do të mundësojnë tërheqjen e kapitalit të ri të freskët për kompanitë e vogla dhe të mesme në Maqedoni që në vitet e fundit kanë probleme të mëdha me disponimin me paratë kesh apo paratë e gatshme. Grantet sigurojnë të holla për përkrahjen e cilësisë së prodhimeve, fitimin e certifikatave për cilësi, efikasitetin energjetik, hulumtim dhe zhvillim, marketing dhe ambalazh të ri, vendosjen e shërbimeve dhe prodhimeve të reja, rritjen e kapacitetit të të punësuarve.

Mjetet që të premtën filluan të ndahen nga ana e Fondit të Inovacio-

nit përbëhen nga një set prej pesë masash, si pjesë e të shtyllës së tretë të Planit qeveritar për zhvillim ekonomik. Ai përfshin në vete përkrahjen për kompanitë e vogla dhe të mesme që kanë tendencë të rritjes. Masa e parë paraqet përkrahje financiare direkte në vlerë prej 30 për qind të harxhimeve të drejtpërdrejta të pranueshme për përkrahjen e firmave të vogla dhe të mesme me tendencë të rritjes së shpejtë, apo "gazelave", por jo më shumë se 10.000.000 denarë për projekte investuese si ndërtimi i kapaciteteve prodhuese, blerja e pajisjeve apo tokës, implementimi i ligjeve evropiane teknike për siguri të prodhimeve, vendosja e sistemeve për menaxhim me mbeturinat etj. Masa e dytë e përkrahjes financiare për kompani me të ardhura deri në 3.000.000 denarë me mbulimin e harxhimeve deri 30 për qind por jo më shumë se 5.000.000 denarë. Për shkak se masat i dedikohen zhvillimit dhe zbatimit të zgjidhjeve inovative, përqindja më e madhe e mbulimit të harxhimeve deri në 70 për qind (por jo më shumë se 20.000.000 denarë), është parashikuar për masën e tretë, apo zhvillimin dhe vendosjen e prodhimeve dhe shërbimeve të reja, ose përmirësimin e atyre ekzistuese si dhe përpunimin e dizajnit industrial apo redizajnimin e prodhimeve, ambalazhimin e ri, marketing planet, vendosjen e procesit të ri prodhues apo përmirësimin e atij ekzistues. Masa e katërt parashikon përkrahje financiare për trajnimin profesional dhe praktikën e të punësuarve, ndërsa masa e fundit parashikon investimet shtesë në biznes.

Kapen 13 emigrantë ilegalë nga Irani

Shkup, 13 korrik - Pjesëtarë të policisë kufitare kanë kapur 13 emigrantë nga Iraku, por edhe në mëngjes në afërsi të pompës së benzinës në autostradën Kumanovë-Tabanoc. Emigrantët janë kapur pas njohurive të marra operative për kontrabandë të emigrantëve nga ana e shërbimeve policore nga policia kufitare - Qendra rajonale - Veri. Emigrantët kanë qenë pa dokumente, nëntë prej tyre ishin burra, dy gra dhe dy fëmijë. Ata kanë lëvizur në drejtim nga Kumanova drejt vendkalimit Tabanoc. Një person, i cili ka qenë pjesë e grupit, shëtitas i Maqedonisë, i cili duhej t'i strehoj emigrantët në rajon në fshatin Vaksincë, paraprakisht i ka lënë dhe ka ikur. Emigrantët janë marrë në pyetje. Ata kanë deklaruar se nga ana e personit të panjohur janë transportuar nga kufiri jugor drejt KK-Tabanoc me automjetet i tipit "Audi-A8". Sipas rrëfimit të tyre, personi i panjohur ka kërcënuar dhe nga çdonjëri prej tyre ka marrë nga 3.000 euro për t'i bartur në kufirin grek afër Beogradit. Sipas tregimit të tyre, i njëjti i ka mashtruar dhe me dhunë i ka shkarkuar në afërsi të pompës të benzinës në drejtim të KK-Tabanoc. Pas marrjes së masave dhe aktiviteteve operative, dhe pas kontrolleve të kryera, është konstatuar se bëhet fjalë për personin F.B. (35) nga Studeniçani i Shkupit. Nga ana e Qendrës rajonale për punë kufitare - Veri është dërguar njoftim deri tek PSP për SKO-Shkup.

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 13 korrik - Kompanitë përfituese të granteve të pakthyeshme qeveritare që u ndanë të premtën nga ana e Fondit për inovacione dhe zhvillim teknologjik, do të hapin 85 vende të reja pune. Njëherësh 79 kompani të teknologjisë informatike, energjetikës, bujqësisë, shëndetësisë etj. që aktualisht punësojnë 375 punëtorë, përveç punësimeve të reja do të rrisin edhe konkurrencën e tyre.

"Numri kaq i madh i fituesve të granteve flet se kemi qëlluar edhe targetin edhe masat e dedikuara për kompanitë. Duhet theksuar se Maqedonia nuk është një shtet i pasur me resurse të tjera, përveçse me resurse njerëzore, andaj kompanive që sot ju ndajmë grantet dëshirojmë ti shohim të orientuara në eksport, për shkak se vetëm orientimi i tyre në eksport mund të sjellë zhvillim të ekonomisë së Maqedonisë. Gjithashtu gëzon fakti se 88 për qind e këtyre mjeteve bëjnë pjesë në programin për inovacion", thotë zë-

Për gjashtë muaj, janë punësuar 1100 mjekë dhe infermiere

Shkup, 13 korrik - Rreth 1.100 persona janë punësuar, gjatë gjashtë muajve të kaluar në institucionet shëndetësore publike. Prej tyre, më së shumti mjekë dhe infermiere, ndërsa shumë më pak punonjës administrativë. "Do të vazhdojmë t'i implementojmë të gjithë masat me qëllim që t'i mbajmë mjekët e rinj në shtet", theksoi ministri i Shëndetësi-

së Venko Filipçe. Sipas tij të vazhdojë rritja e pagave nga shtatori, në mënyrë plotësuese edhe nga janari i vitit të ardhshëm dhe do ta përmirësojnë edukimin në mënyrë që do të bashkëpunojnë me universitetet e huaja. "Gjatë vizitës time në Izrael u dakordua këmbim i mjekëve para së gjithash në sferën e transplantimit, por edhe në të gjithë sfer-

rat e tjera të ekspertizës, të cilët do t'i caktojmë si prioritete tona. Çdo muaj mjekët tanë do të mund të shkojnë në njërin nga spitalet më të njohura në Tel-Aviv të edukohen në profesionet e tyre, të qëndrojnë sa konsiderojnë se është e mjaftueshme në varshmëri nga niveli i ekspertizës dhe pastaj të kthehen në vendet e tyre të punës. E di se është e

vështirë, por jam shumë i sigurt se e gjithë kjo do t'i motivojë mjekët që të qëndrojnë në vendin tonë", tha Filipçe. Planifikohet edhe një valë plotësuese e punësimeve të kuadrit për të cilin për momentin nuk ka mjete financiare, për të cilat gjithashtu do të sigurohen mjete plotësuese nga buxheti dhe kjo do të bëhet në shtator. (D.K)



Gostivar, 13 korrik - Kryetari i Komunitetit të Gostivarit, Arben Taravari, dërgoi apel deri te bashkëqytetarët dhe policia që të tregohen më zemërgjerë dhe më mikpritës ndaj mërgimtarëve të cilët këtyre ditëve vijnë në vendlindje. Që ata

TARAVARI KËRKOJNË MIKPRITJE DHE TOLERANCË NDAJ MËRGIMTARËVE

të kenë qëndrim më të këndshëm nga bashkëqytetarët dhe nëpunësit policorë, Taravari pret tolerancë më të madhe dhe më pak ndëshkime Apeli i kryetarit të komunitetit vjen në periudhë kur pritet fluksi më i madh i mërgimtarëve. "Mërgimtarët vijnë vetëm për pak ditë në vendlindje. Gjatë atyre pak ditëve, ata shpenzojnë dhe investojnë aq shumë para, sa që mbajnë të gjallë ekonominë e vendit. Nëse

një pjesë e vogël e tyre, kryesisht të moshës rinore, nuk janë sa duhet të disiplinuar në trafikun rrugor, dhe bashkë edhe me të rinjtë tjerë të qytetit tonë bëjnë veprime të cilat pak më vështirë mund t'i pranojnë gjeneratat më të vjetra, duhet të tregohemi pak më zemërgjerë dhe më tolerantë përderisa veprimet e tyre nuk lënë pasojë, ose nuk paraqesin ndonjë shkelje më të rëndë të ligjit dhe

normave ligjore", qëndron në apelin e Taravarit. Në apel ai i drejtohet edhe komandantit të Stacionit të Policisë në Gostivar që t'i mobilizojë nëpunësit policorë, për siç thekson, të qenë në nivel të detyrës, të ndikojnë më shumë në mënyrë preventive dhe të asistojnë sa më shumë që të menaxhohet me sukses fluksi i rritur në trafik, pa mos pasur nevojë për masa ndëshkuese. Apeli i fundit të Tara-

varit që e dërgoi në letër deri te komandanti i SP Gostivar hasi në reagim nga MPB, për shkak se siç është thënë atëherë, nuk do të ketë seleksionim ndaj kundërvajtësve dhe tolerancë për sjelljen e tyre. Reagime negative nëpër rrjetet sociale kishte edhe vendimi i autoriteteve komunale me të cilin mërgimtarëve do t'u mundësohet që t'i dërgojnë fëmijët në çerdhe derisa janë në vendlindje.



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPLLJE PUBLIKE NUMËR – 101/2018

për punësimin e 13 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Agjencioni për barna dhe pajisje medicinale “për vendet e punës në vijim:

<p>1. UPR 0101V02000 Bashkëpunatori i lartë për analiza dhe informacione për barna, Njësia për mendime farmakoekonomike dhe farmakoepidemiologjike, Sektori për informacione për barna dhe pajisje mjekësore</p> <p>Kushtet e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë, - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase, - Të jetë i moshës madhore, - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës. <p>Kushtet e posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 300 ose 360 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat mjekësore fundamentale ose farmaci - së paku 2 (dy) vjet përvojë pune në profesion <p>Kompetencat e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij - mësim dhe zhvillim - komunikim - arritje të rezultateve - puna me të tjerë/puna ekipore - ndërgjegjësim strategjik - orientim kah palët/palët e interesuara; dhe - menaxhim financiar <p>Kompetenca të posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) 	<p>2 realizues(ë)</p> <p>VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.</p> <p>3. UPR 0101V02000 Bashkëpunatori i lartë për licencimin e prodhimit të barnave dhe pajisjeve mjekësore, Njësia për licencimin e barnave dhe pajisjeve mjekësore, Sektori për mbikëqyrje inspektoriale dhe licencim të barnave dhe pajisjeve mjekësore</p> <p>Kushtet e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë, - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase, - Të jetë i moshës madhore, - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës. <p>Kushtet e posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 300 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, farmaci - së paku 2 (dy) vjet përvojë pune në profesion <p>Kompetencat e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij - mësim dhe zhvillim - komunikim - arritje të rezultateve - puna me të tjerë/puna ekipore - ndërgjegjësim strategjik - orientim kah palët/palët e interesuara; dhe - menaxhim financiar <p>Kompetenca të posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) 	<p>Rroga neto: 23.258,00 denarë</p> <p>VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1, Shqiptar(e) 1, Turk(e) 1.</p> <p>5. INS0101V04001 Inspektor i ri për mbikëqyrje mbi prodhimin dhe fitimin e barnave dhe pajisjeve medicinale, Njësia për inspektim në fushën e barnave dhe pajisjeve medicinale, Sektori për mbikëqyrje inspektoriale dhe licencim të barnave dhe pajisjeve mjekësore</p> <p>Kushtet e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë, - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase, - Të jetë i moshës madhore, - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës. <p>Kushtet e posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 3000 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, farmaci - me ose pa përvojë pune - Në pajtim me ligjin për inspektim, të posedojë licencë për inspektor nga sfera e kompetencave për shërbime inspektoriale <p>Kompetencat e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij - mësim dhe zhvillim - komunikim - arritje të rezultateve - puna me të tjerë/puna ekipore - ndërgjegjësim strategjik - orientim kah palët/palët e interesuara; dhe - menaxhim financiar <p>Kompetenca të posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
<p>2. UPR0101V02000 Bashkëpunatori i lartë për dhënie e lejes për pajisje medicinale, Njësia për pajisje medicinale, Sektori për vlerësim të dokumentimit dhe lëshim të barnave dhe pajisjeve mjekësore në qarkullim</p> <p>Kushtet e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë, - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase, - Të jetë i moshës madhore, - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës. <p>Kushtet e posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 300 ose 360 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat medicinale fundamentale ose farmaci ose stomatologji - së paku 2 (dy) vjet përvojë pune në profesion <p>Kompetencat e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij - mësim dhe zhvillim - komunikim - arritje të rezultateve - puna me të tjerë/puna ekipore - ndërgjegjësim strategjik - orientim kah palët/palët e interesuara; dhe - menaxhim financiar <p>Kompetenca të posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) 	<p>1 realizues(ë)</p> <p>VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1, Shqiptar(e) 1.</p> <p>4. UPR 0101V02000 Bashkëpunatori i lartë për furnizim me barna, Njësia për barna humane, Sektori për vlerësim të dokumentimit dhe lëshim të barnave dhe pajisjeve mjekësore në qarkullim</p> <p>Kushtet e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë, - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase, - Të jetë i moshës madhore, - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës. <p>Kushtet e posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve me të kryer 300 ose 360 sipas EKTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat mjekësore fundamentale ose farmaci - së paku 2 (dy) vjet përvojë pune në profesion <p>Kompetencat e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij - mësim dhe zhvillim - komunikim - arritje të rezultateve - puna me të tjerë/puna ekipore - ndërgjegjësim strategjik - orientim kah palët/palët e interesuara; dhe - menaxhim financiar <p>Kompetenca të posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) 	<p>Rroga neto: 23.258,00 denarë</p> <p>VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Turk(e) 1.</p> <p>6. INS0101V02001 Inspektor i ri për mbikëqyrje mbi prodhimin dhe fitimin e barnave dhe pajisjeve medicinale, Njësia për inspektim në fushën e barnave dhe pajisjeve medicinale, Sektori për mbikëqyrje inspektoriale dhe licencim të barnave dhe pajisjeve mjekësore</p> <p>Kushtet e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë, - Ta njohë mirë gjuhën maqedonase, - Të jetë i moshës madhore, - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, - Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës. <p>Kushtet e posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 300 kredi sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, farmaci - së paku 2 (dy) vjet përvojë pune në profesion - Në pajtim me ligjin për inspektim, të posedojë licencë për inspektor nga sfera e kompetencave për shërbime inspektoriale <p>Kompetencat e përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij - mësim dhe zhvillim - komunikim - arritje të rezultateve - puna me të tjerë/puna ekipore - ndërgjegjësim strategjik - orientim kah palët/palët e interesuara; dhe - menaxhim financiar <p>Kompetenca të posaçme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë - njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)
	<p>3 realizues(ë)</p> <p>VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1, Shqiptar(e) 1, Turk(e) 1.</p>	<p>Rroga neto: 20.987,00 denarë</p>

POLICIA NUK KA MARRË KËRKESË PËR KAHËZIMIN E KOMUNIKACIONIT

RRUGËT NJËKAHËSHE PRESIN KËSHILLIN

Në Sektorin për komunikacion në Komunën e Tetovës thonë se pas tërheqjes nga rendi i ditës si propozim-vendim, janë bërë konsultime shtesë dhe dokumentacioni sërish është dërguar në Këshillin komunal



Koha Urim HASIPI

Tetovë, 13 korrik - Shpallja e rrugëve njëkahëshe në Tetovë, që janë rreth 20, ende nuk merr dritë të gjelbër nga ana e Këshillit të Komunës së Tetovës. Sipas informacioneve të deritanishme, kjo pikë e rendit të ditës njëherë është hequr nga rendi i ditës kurse më pas, nuk është vendosur. Edhe nga Këshilli edhe nga Komuna e Tetovës thonë se mosvendosja në rend dite është bërë për shkak të konsultimeve shtesë pasi kur rrugët të shpallen njëkatëshe, të njëjtat nuk mund të ndërrohen.

"Nuk ka problem, mirëpo i njëjti propozim vendim para dy seancave është sjellë në seancë, më pas është hequr nga rendi i ditës për dokumentacion shtesë. Qëllimi është që kur e njëjta pikë të vijë në rend dite, të prezantohet para këshilltarëve dhe rrugët që planifikohet të jenë njëkatëshe, të vendosen si të atilla për të mirën e qytetarëve dhe të jenë në funksion për të zbutur kaosin në komunikacionin në rrugët e qytetit të Tetovës. Pikërisht kjo ka qenë arsyeja që kjo pikë ende nuk është vendosur në rend dite dhe kur të jetë e gatshme - do të miratohet", tha Bekim Memeti. Nga ana e sektorit për komunikacion në Komunën e Tetovës thonë se pas tërheqjes nga rendi i

ditës si propozim-vendim, janë bërë konsultime shtesë dhe dokumentacioni sërish është dërguar në Këshill. "Para dy seancave ishte në rend dite kjo pikë, por me kërkesë të këshilltarëve, është tërhequr nga rendi i ditës me qëllim që të bëhen konsultime shtesë. Këto konsultime së bashku me vërejtjet janë rregulluar dhe kompletuar në dokumentacion dhe janë dërguar që në seancën paraprake, por ende nuk janë gjendur në rend dite. Tashmë është punë e këshillit se kur do të kalojnë në seancë dhe është në duart e këshillit, kurse në së bashku me policinë kemi bërë koordinimet e nevojshme", thonë nga sektori për

komunikacioni pranë Komunës së Tetovës. Nga Policia e Tetovës thonë se Komuna ende nuk ka dërguar kërkesë për marrjen e pajtueshmërisë për rrikahëzimin e disa rrugëve në njëkahëshe e që paraqet një obligim të rregullt ligjor. "Nëse do të kishte një kërkesë të këllill, menjëherë ekipet tona do të dalin në teren dhe do të vërtetojnë se a janë plotësuar kushtet dhe kriteret për marrje të pajtueshmërisë për rrikahëzimin e komunikacionit. Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, konkretisht sipas disa pa-

MBROJTJE E KULLOSAVE TË MALIT SHARR

Me një fond prej afër 4.5 milionë denarë në periudhën prej 4 maj të këtij viti deri më 4 shtator të viti 2019, do të realizohet projekti i mbrojtjes së bio-diversitetit të kullosave të Malit Sharr. Qëllimet kryesore të projektit janë përkrahja e zhvillimit ekonomik lokal, punësimeve të reja, brendimi i prodhimeve dhe ofertës agroturistikë të zonës e kështu me radhë. Gjithashtu, analizat do të tregojnë se cilat kullosat nga afër 50 mijë hektarë që gjenden në zonën e Malit Sharr do të kenë mundësi që përmes planit investues edhe të revitalizohen. Një vëmendje e veçantë pritet ti kushtohet edhe trajtimit të dëllenjave. Parashikohet edhe forcimi i kapaciteteve për menaxhimin e qëndrueshëm të kullosave, furnizimin me ujë të bagëtive, punëtori të ndryshme si dhe në fund edhe promovimin e brendeve lokale duke krijuar edhe uebfaqe për promovimin e tyre. Projekti financohet nga ana e BE, ndërsa zbatohet nga ana e shoqatës "MilieKontakt", në partneritet me Ndërmarrjen e Kullosave dhe shoqatën e agroekonomistëve të Maqedonisë. (F.P)

rametrave do të vlerësojë cila rrugë pas rrikahëzimit mund të ndikojë në sigurinë e përgjithshme në komunikacionin rrugor në pajtim me rregullativën ligjore", thuhet në përgjigjen me shkrim të Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë. Nga Policia e Tetovës njoftojnë gjithashtu se vazhdojmë të marrin masa dhe aktivitete për siguri më të madhe në komunikacionin rrugor në Tetovë dhe rrethinë. Sidomos kjo ka të bëjë me rritjen e frekuencimit të automjeteve në rrugët e Tetovës në këtë periudhë.

Publicitet

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 22.500,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

7. UPR 0101V04000 Bashkëpunor më 2 realizues(ë) i ri për përpunim të të dhënave nga sfera e barnave, Njësia për barna humane, Sektori për vlerësim të dokumentimit dhe lëshim të barnave dhe pajisjeve mjekësore në qarkullim

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve me të kryer 300 ose 360 sipas EKTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat mjekësore fundamentale ose farmaci
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij

- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 20.987,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 2.

8. UPR 0101V04000 Bashkëpunor më 1 realizues(ë) i ri për përpunim të të dhënave nga sfera e pajisjeve mjekësore, Njësia për pajisje mjekësore, Sektori për vlerësim të dokumentimit dhe lëshim të barnave dhe pajisjeve mjekësore në qarkullim

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve me të kryer 300 ose 360 sipas EKTS ose të kryer shkallën VII/1, shkencat mjekësore fundamentale ose farmaci ose stomatologji

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij

- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 20.987,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

9. UPR0101V01000 Këshilltar për futjen dhe analizën e të dhënave, Njësia për përkrahjen informative, Sektori për punë juridike dhe të përgjithshme, përkrahje informative dhe punë administrative-teknike

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënimi ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

SS-FAKTORI: “Sela” e “Sazdovski”

Nga
Daut DAUTI



E pata nisur një seri shkrimesh, që dua ta ndërpres pa dashjen time. Pas Micskovskit dhe Zaevit, radhën e kisha për shkrimin “Të (mos) jesh Ali Ahmeti”, por mbeti për javën tjetër, me kusht që të mos dalë ndonjë temë tjetër që t’ma prishë planin. Si kjo për vrasjen e pjesëtarit të grupit të tifozeve “komitet”. Dua ta them haptas se kërkoj dënimin e merituar për sulmuesit e tij, por dhe se duhet të jemi të brenjosur për këtë dukuri që shkakton këso incidentesh tragjike...Do të kisha bërë dhe apel për publikun e gjerë që këtë vrasje ta trajtojë dhe përjetojë si çdo tragjedi ku dikush vret dikë, si një kontekst midis dy palëve ku përveç guximit të budalakaftë për të marrë jetë për shkaqe banale (supozojmë fyerjet verbale në baza etnike!), ka dhe gjithçka që “duhet” të ketë dhe faktorin e shkak-pasojës, pra, nuk është tragjedi rasti. Jo që dua të ikë nga fjala vrasje dhe parapëlqej fjalën tragjedi, po pse mendoj se pikërisht si tragjedi duhet të trajtohet, kur është pasojë e një fare të mbjellë që në fillim të viteve 90-të (ndoshta dhe një dekadë më herët si refleksi i disa proceseve të kohës), pra të farës së urrejtjes, e cila pastaj ka ardhur duke bërë “frutë” dhe sot “vjelim” tragjedi... Emri i viktimës sot është Nikolla Sazdovski, por hiq më pak se para një viti e ndonjë muaj, ai që do të përfundonte si do të quhej Zijadin Sela... Fakti që mbeti gjallë nuk e bën më të vogël veprën, veprën që motiv ka urrejtjen patologjike, veprën mizore që dikush e bën duke urrejtur të tjerët...

Rastisi që mbiemrat e të dyve fillojnë me shkronjën S dhe që i lidh një fenomen, më shtyri që këtë koincidence ta quaj “SS-faktor”, pa dashur

që të shkaktoj keqkuptime me ndonjë kontekst kohor tjetër të kësaj shkurtese...

Vepra ndaj Sazdovskit ka edhe elementin që e lidh me rastin e Selës: qyqarllëkun. Këtu te fatkeqi Sazdovski ishin gjetur tre persona që e kishin sulmuar, pra “tre veta ndaj një” dhe e kishin lënë me plagë vdekjeprurëse. Kushedi sa herë nga “tre veta ndaj një” kishin shfryrë mllëfin ndaj Selës, duke e lënë pa shenja jete, kur sulmuesit e tij kishin menduar se e “kanë kryer punën”, pra, “detyrimin patriotik” ndaj “atdheut”... Sulmuesit ndaj Selës tashmë e fituan dënimin e merituar. Një dënim të tillë e meritojnë edhe sulmuesit ndaj Sazdovskit fatkeq...

I përmenda vitet 90-të, kohën e ardhjes së lirisë dhe demokracisë, kohën e referendumeve të pavarësisë në ish Jugosllavi e më pas, i kushtetutës rigjide dhe lindjes së partive që në platformën e tyre kishin luftën ndaj rrezikut shqiptar, kur një parti politike që atëherë përmendi problemin e 150 mijë kosovarëve (pra, kjo temë nuk është që e shpiku e njëjta parti pas regjistrimit të fundit të popullsisë se gjoja dikush u ka dhënë shtetësi, por që në kohën e Lubço Georgievskit). Vazhdoi të thellohet hendeku, kur çdo kërkese shqiptare haste në homogjenizim etnik maqedonas, kur për hapje fakultetesh (Pedagogjiku...), dilnin e protestonin studentë maqedonas me “komora gazi”... Ajo frymë e atëherëshme ka vazhduar edhe pas 2001-shit, sa për një kryetar shqiptar të Kuvendit, para një viti dish u rrënuan institucionet e shtetit, dish u vranë deputetë. Gjatë gjithë kësaj kohe, një tifozeri të njëjtën frymë e ke përçarur në stadiume, duke “i helmuar” shqiptarët që

pastaj “natyrshëm” (natyrshëm, ë?!), të gjejë dhe rivalë në palën tjetër...

Por, dua të them troç se nuk pajtohem me atë që thanë disa se vrasjes së Sazdovskit nuk duhet t’i jepet dimension ndëretnik. Natyrisht, vrasja është vrasje dhe nuk duhet të përgjithësohet dhe pajtohem me qëllimin e mirë, për ta qetësuar situatën, por nuk duhet të heshtet kur faktet flasin për një të vërtetë. Këtu nuk bëhet fjalë për një incident të rastësishëm huliganësh, por për një tragjedi ku urrejtja ndëretnike ka luajtur rol vendimtar. Sa “duhen” mes vete “komitet” dhe “shfercerat” flet vendimi parandalues që të mos lejohen bashkë në një ndeshje sportive. Kjo është e kobshme për sportin, por dhe për atmosferën në shoqëri në përgjithësi. Kemi të bëjmë me një urrejtje të kultivuar në dy rrafshë: e para, në planin e urrejtjes sportive midis klubeve (siç janë rivalitetet e dhunshme midis “komitëve” të Vardarit dhe “çkëmbareve” të Pelisterit të Manastirit) dhe e dyta, me faktorizimin e klubeve me pronarë shqiptarë, ajo merr edhe karakter ndëretnik. Kjo urrejtje që e përhapin tifozeritë, para së gjithash “komitet” e Vardarit, shpesh është përshkuar edhe me incidente të dhunshme, ku përveç akteve vandale ndaj pronës shoqërore ose private, janë sulmuar edhe njerëz të rastit rrugëve, shesheve, e madje nëpër mëhalla (rasti kur “komitet” madje u hynë nëpër shtëpi shqiptarëve në lagjen e Nerezit). Këto shfryrje të urrejtjes patologjike kanë kaluar edhe nëpër rrjete sociale, nëpër rrugë, sheshe e stacione dhe ja parakushtet për incidente.

Nga këndvështrimi shqiptar, me shumë fakte, mund të nxirret konkluzioni se të shpeshtën veprat e njëjta

Kjo është ajo situatë që si shoqëri duhet ta tejkalojmë, që të mos na ndodhë që të shtohet mosbesimi dhe frustrimi me ngjyrimet gjithfarëshe, sa dikush ta merr “drejtësinë” në duart e veta. Të mos na ndodhë që ta shohim rastin e Selës e të mos e shohim atë të Sazdovskit, ose ta shohim të Sazdovskit e ta harrojmë atë të Selës, që janë pjesë e një fenomeni



nuk kanë pasur epilog të njëjtë nëse kruesit kanë qenë të etnive të ndryshme, gjegjësisht, siç cekta më lartë, kryesve shqiptarë gjykatësit u kanë shqiptuar dënime jashtë çdo logjike juridike. Mirëpo, në rastin e Nikolla Sazdovskit, shokët e tij “komitet” u janë kthyer klisheve që mbretërojnë te opinionin maqedonas, kur thonë se ai “ka qenë i sulmuar nga njerëz që veten e quajnë tifoze, e që në të vërtetë janë kriminelë, dilerë, vrasës dhe MBI TË GJITHA, TË MBROJTUR SI ASKUSH TJETËR NË SHITET” (nënv.im). Këtu, natyrisht, nuk do të ishte e plotë nëse me tragjedinë nuk do të ndërli dhej politika për përplasje midis pushtetit dhe opozitës, me hipokrizinë që tashmë botërisht e njohur: me të drejtë kërkojnë dënim për vrasjen e Sazdovskit, ndërkaq i bëjnë të gjitha obstrukcionet, me kushtëzime e madje dhe shantazhe, që të falen (tentim)vrasësit e Selës. Kjo hipokrizi nuk është vetëm një rakurs politik për të përfutur (ndonjë poen politik) nga situata (tragjedia), por dhe më serioze se kjo ndoshta. Është ai këndvështrimi që dhembja për pjesëtarin e vet të jetë më e madhe se vaji i ndonjë nëne të një pjesëtari tjetër! Sigurisht ka shumë të drejtë gazetari Branko Triçkovski kur thotë se “Refleksi Pavllavian i kombit funksionon sipas tingullit të tragjedisë, krejt një nëse është tragjedia e vërtetë ose rreme, krejt një nëse përmban vrasje, platforma, marrëveshje...”, për të vazhduar: “Fatkeqësia është ajo shtysë për njerëzit-qen. Koci i tyre. Këta që kërkojnë amnisti për një sulm të përgjakshëm, ku për fije floku u evituan epilogët vdekjeprurës, kërkojnë që të dënohen maksimalisht vrasësit e Sazdovskit. Unë kërkoj që të dënohen që sot, por ky

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovsja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e premtë 13 korrik | Numri i parë i gazetës do të më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

ekskluziviteti i pamend dhe morbid në qëndrimet e disa aktorëve, e theksoj që ta ilustruj tezën dhe të them se askush nuk ka të drejtë t'i shterë lotët e prindërve dhe të afërmeve të djaloshit, me patetikë dhe teatralitete me budallallëqe grandioze në të cilat ngjajnë këso dramash.

Dhe këtu do t'i jap të drejtë edhe kolegut Emin Azemi, i cili potencon edhe barikadimin e medias "në qëndrime ekskluzivisht etnike" me "mungesë të kurajos qytetare për të sfiduar keqbërësit që vijnë brenda etnisë së tyre". Këtu vërtet çalojnë pothuajse të gjitha mediat, të cilat shpesh dine "mizën ta bëjnë buall", ose anasjelltas, "buallin ta bëjnë mizë", në varësi se kush është viktima e kush keqbërësi. Duke u marrë me fenomenin, e jo (vetëm) me rastin e fundit, dua të them pa kurrfarë dileme, jo vetëm pse jam shqiptar dhe mund të jem i njëanshëm, por pse është fakt, se përhapësit më të mëdhenj të urrejtjes ndër tifozeritë në Maqedoni janë "komiteti" e Vardarit. Por, duke analizuar do veprime e raste, nuk janë "lule për t'u marrë erë" as tifozeritë e klubeve shqiptare, të cilat shpesh, duke dashur t'u përgjigjen "komitetëve" ("vojvodëve" etj...), bien në të njëjtat nivele, duke shfryrë energji negative sa ndaj tyre, aq edhe kur ndeshen edhe me tifozë të klubeve simotra (shqiptare). Të mos harrojmë se para disa viteve në një ndeshje të "Bashkimit" me "Shkupin" në Çair, tifozët e lënduan me thikë një futbollist mysafir! Në ndeshje miqësore!!! Ka pasur përplasje të dhunshme edhe midis "ballistëve" dhe "shfercerave"! Në një ndeshje finale për kupën, ku luajti "Shkëndija", tifozët e demoluan një tribunë të stadiumit të Shkupit. (Lidhur me këtë rast, klubi i Shkëndijës (e dënuar me rreth 50 mijë euro për dëmet) u distanca nga përgjegjësia pasi nuk ka qenë organizatore e ndeshjes, por sikur nuk pati guxim t'i akuzojë tifozët që në emër të këtij klubi e bënë atë gjurulldi! Kur e pyeta një "ballist" (e kisha farefis) çka ju desh kjo, ai më tha "nuk e kemi bërë ne, por shfercerat"... Hajt merre vesh këtë punë, askush nuk e merr fajin).

Urrejti ndër etnike dhe urrejti ndaj rivalëve, është një fenomen që shkon me të rinjtë e grupuar në këto tifozeri, por dhe në bankat e shkollës ose fakultete, sigurisht duke bartur me vete edhe shumë refleks të ndasive etnike e fetare në shoqëri. Kur jemi te tifozeritë, çudit fakti që klubet dinë t'i heshtin incidentet dhe paraqitjet e tyre të turpshme, duke kërkuar gjithnjë fajtorin te të tjerët, madje edhe kur ndëshkohen për këtë nga organizatat sportive të vendit ose ndërkombëtare. Klubet nuk distancohen, mediat i minimizojnë ose stërmadhojnë, ne si qytetarë poashtu i mbyllim sytë kur janë në pyetje "tanët", kurse rrjetet sociale "ndihmojnë" për të ngritur në më shumë "oktave" zërat e urrjetjes dhe kështu mund të na ndodhin që dikush për një sharje ose fyerje në stadium ose facebook, të përfundojë në arkivol.

Më e keqja që na ndodh sot është se në një varg incidentesh me pasoja herë në njërin tabor e herë në organet e ndjekjes për dikë kanë qenë nënë e për dikë njerë, dikush për një sulm pa pasoja ka marrë disa muaj burg, dikush për shkak të sulmeve në autobus, ka ndenjur shtatë ditë në burg shtëpiak, dikush që ia ka vizatuar kryqin në gjoks ose bark ndonjë djaloshi ose ndonjë nxënëseje nuk është zbuluar asnjëherë, ose dikujt që ka djegë dyqane e lokale shqiptare i janë dhënë 10 muaj dënim me kusht, e dikujt që ka thyer disa xhama të gjyqit tre vjet...Kjo është ajo situatë që si shoqëri duhet ta tejkalojmë, që të mos na ndodhë që të shtohet mosbesimi dhe frustrimi me ngjyrimet gjithfarëshe, sa dikush ta merr "drejtësinë" në duart e veta. Të mos na ndodhë që ta shohim rastin e Selës e të mos e shohim atë të Sazdovskit, ose ta shohim të Sazdovskit e ta harrojmë atë të Selës, që janë pjesë e një fenomeni.

(Autori është kolumnist i rregullt i gazetës KOHA)

NATO e ka punën pisk!

Nga The Economist

Amerika ka bërë më shumë se çdo vend tjetër për të krijuar Europën e pasluftës. Në vitet 1940-1950 luajti rolin e ndërmjetësit për një traktat që solli BE-në dhe NATO-n, aleancën ushtarake që fitoi Luftën e Ftohtë. SHBA-të vepruan pjesërisht në formë bamirësie, por kryesisht për shkak të interesit të vet. Pasi ishin tërhequr nga të tjerë në dy luftëra botërore, SHBA-të donin të ndalonin rivalitetin franko-gjerman e të ndërtonin një mbrojtje kundër kërcënimit sovjetik. Pas rënies së Bashkimit Sovjetik në vitin 1991, aleanca nisi të promovojë demokracinë në shtetet e sapo çliaruara të Europës Lindore.

Por sot, Amerika dhe Europa janë të ndara nga një krizë që sa vjen e thellohet. Atmosfera përpara takimit dyditor të NATO-s në Bruksel, tani më 11-12 korrik, ka qenë vërtet helmatisëse. Presidenti amerikan, Donald Trump, i akuzon udhëheqësit europianë si shkelës të besimit dhe të paaftë për të ushtruar pushtet aty ku duhet. Ata, nga ana tjetër, e akuzojnë për vandalizëm të pagdhundur. Një samit i dytë, që do të mbahet midis Trump-it dhe Putinit në Helsinki, më 16 Korrik, mund të prodhojë spektaklin e pamendueshëm të një presidenti amerikan që trajton kundërshtarin rus më mirë se ç'ka trajtuar aleatët.

Edhe sikur dy samitet të kalojnë të qeta, (siç priten, meqë Trump pëlqen t'i ngatërrojë ata që e kritikojnë), mosmarrëveshjet dhe përplasjet kulturore e politike do të mbeten aty. Aleanca e perëndimit e ka punën pisk, dhe kjo duhet të shqetësojë Europën, Amerikën dhe të gjithë botën mbarë. Çdo aleancë ka tensionet e veta, por ajo e Perëndimit i ka të përhapura në fronte të ndryshme. Trump dhe gjeneralët e tij qortojnë pa pushim anëtarët e NATO-s që nuk respektojnë premtimin për të rritur shpenzimet e mbrojtjes në 2% të PBB, deri në vitin 2024. E djathta amerikane qorton mbështetjen europiane të marrëveshjes bërthamore me Iranin, nga e cila Trump u tërhoq, dhe e sheh si një sjellje të njëanshme karshi Izraelit. Ligjvënësit nga të dy partitë amerikane mendojnë se tekta vëmendja e botës po kthehet në Azi, europianët e BE, që "dinë vetëm të ankohen e që marrin pamje shenjtori", meritojnë më pak nga koha e tyre.

Sikur të mos mjaftonte kjo, Trump e ka akuzuar BE-në se po përpiqet të përfitojë nga SHBA-të nëpërmjet një tregtie të padrejtë. Europa, ndërkohë, mbetet e përçarë. Italia ka një koalicion populist që është pro Putinit. Turqia, që është anëtare e NATO-s, por jo në BE, mbetet armiqësore ndaj vlerave të demokracisë liberale që e mbajnë aleancën të bashkuar. E ardhmja mund të jetë edhe më keq se kaq. Një qeveri laboriste në Britani, nën drejtimin e Xheremi Korbinit, i cili ka vite që e kundërshton angazhimin ushtarak nga Perëndimi, mund ta shohë Amerikën

me dyshime edhe më të mëdha, e madje mund të përpiqet ta nxjerrë Britaninë nga NATO. Aleanca Perëndimore ia vlen të ruhet. Në një botë të rrezikshme, gjithnjë e më autoritare, NATO mund të shërbejë si burim jetik që ofron siguri dhe si bastion i demokracisë. Por Aleanca nuk e ka mbijetesën të garantuar nga Zoti. Duhet ta meritojë vendin e vet, vazhdimisht. Pyetja është se si.

Hapi i parë është të mos e bësh punën edhe më të vështirë. Europa duhet të bëjë gjithçka që mundet për t'i mbijetuar instinkteve të Trump-it për ta përzier tregtinë me sigurinë. Përzjerja e këtyre dy fushave do ta bënte Perëndimin më pak të sigurt e më të varfër.

Mbështetësit e aleancës duhet të jenë praktikë. Kjo do të thotë që duhet të paguajnë. Trump ka të drejtë që ankohet për vende si Gjermania e Italia, të cilat shpenzojnë 1.22% dhe 1.13% të PBB për mbrojtjen. Në fakt, ai mund të shkojë edhe më tej. Shumë pak nga paratë që shpenzohen për mbrojtjen janë në fakt të dobishme. Një e treta e parave që shpenzon Belgjika shkojnë për pensione. Duhet të shpenzohet më shumë për kërkime shkencore, zhvillim dhe pajisje. Për aleatët e Amerikës, të jesh praktik do të thotë gjithashtu të ruash ritmin e kohës. Bashkëpunimi në fusha si siguria kibernetike do ta bëjnë aleancën më të vlefshme për Amerikën. NATO-ja duhet të vazhdojë të japë një përgjigje më të mprehtë ndaj taktikave të dezinformimit e të infiltrimit që ka përdorur Rusia në Krime dhe në Ukrainë. Politika bën vetëm larje e lyerje. Është e vështirë të rikthehen e njohuritë ushtarake në një vend që i ka humbur me kohën. Manovrat që e mbajnë NATO-n të bashkuar janë më jetike se kurrë.

Të jesh praktik do të thotë të qëndrosh bashkë. Teksa negocion për Brexit, BE-ja është e vendosur ta mbajë Britaninë jashtë strukturave të sigurisë së bllokut, ngaqë nuk do të jetë më anëtare. Por me përvojën ushtarake që ka Britania, me industrinë e armëve dhe agjencitë e informimit që zotëron, kjo është një humbje për vetë BE-në. BE duhet të përpiqet ta afrojë Britaninë duke reklamuar Iniciativën e Ndërhryjes Europiane, të propozuar nga Franca, e cila ka si qëllim të krijojë një forcë që mund të veprojë në kohë krize. Amerika do ta kishte parë një plan të tillë si kërcënim ndaj NATO-s. Sot duhet të shërbejë si garanci dhe si shenjë që Europa është e gatshme të ndërmarrë më shumë përgjegjësi.

Lufta e fundit është ajo e ideve. Po të mos kishin ekzistuar në kohë të tjera, NATO dhe BE nuk do të ishin krijuar në kohët e sotme. Që nga rënia e Bashkimit Sovjetik, ndjesia e kërcënimit është zbutur dhe janë shfaqur më shumë pengesa bashkëpunimi. Prapë, kjo nuk e bën NATO-n të panevojshme, siç deklaroi Trump dikur. Aleancat e Amerikës janë një vlerë që shihen me zili nga Ru-


Azia po vëzhgon, njësoj si Putini. Sa më shumë t'i ngacmojë Trump aleatët, aq më shumë bota do ta shohë me dyshim rolin e Amerikës si garantuese e sigurisë. Dhe ngaqë fuqitë e mëdha konkurrojnë në një zonë gri midis paqes dhe luftës, shtohet rreziku që të bëhen llogaritë gabim kur të jetë nevoja. Trump beson se është mjeshtër për të bërë negociatë, me synimin për të forcuar Amerikën. Me Europën, ashtu si me shumë gjëra të tjera, ai po nënvlerëson atë që po largon nga vetja



sia dhe Kina. NATO është një trashëgimi që bëhet më e çmuar duke qenë e pazëvendësueshme. Nevoja për siguri mbetet. Rusia nuk është Bashkimi Sovjetik, por, si fuqi në rënie, ndihet e kërcënuar. Për këtë arsye ka modernizuar forcat ushtarake dhe është e përgatitur t'i vërë në veprim. Nevoja për të përdorur demokracinë europiane si ankorim, mbetet po ashtu e pranishme. Autoritarianizmi sa vjen e shtohet në Poloni e Hungari, e NATO dhe BE mund të ndihmojnë që ta ndalojnë. Përfitimet e tjera janë te mënyra se si Europa e ndihmon Amerikën ta projektojë pushtetin e vet duke ofruar baza, trupa dhe, zakonisht, mbështetje diplomatike.

NATO është më e brishtë se ç'mendon Trump. Thelbi i ekzistencës së saj është betimi për ta quajtur sulmin ndaj secilit prej vendeve anëtare si sulm ndaj gjithë të tjerëve. Pavendosmëria e tij dhe armiqësia ndaj Europës e ka zbutur atë premtim, si dhe zbulon pakënaqësinë që ka ai për faktin që vendet e vogla kanë të njëjtat të drejta si vendet e mëdha. Azia po vëzhgon, njësoj si Putini. Sa më shumë t'i ngacmojë Trump aleatët, aq më shumë bota do ta shohë me dyshim rolin e Amerikës si garantuese e sigurisë. Dhe ngaqë fuqitë e mëdha konkurrojnë në një zonë gri midis paqes dhe luftës, shtohet rreziku që të bëhen llogaritë gabim kur të jetë nevoja. Trump beson se është mjeshtër për të bërë negociatë, me synimin për të forcuar Amerikën. Me Europën, ashtu si me shumë gjëra të tjera, ai po nënvlerëson atë që po largon nga vetja.



HUALLI



Kakuro

5x5 dhe 6x6

Kakuroja është kombinim i fjalëkryqit dhe Sudoku. Në vend të shkronjave shënohen numra edhe atë prej 1 deri 9. Numrat nuk duhet të përsëriten as horizontalisht e as vertikalisht. Numrat brenda fushave duhet t'i japin shumat, të cilat janë dhënë në skajet e fushave që duhet të plotësohen.



Koha, e shtunë, 14 korrik 2018

KOHA e lirë
për më të rinjtë



FJALËKRYQI (Kupa Botërore)

Plotësojeni fjalëkryqin duke i shënuar 32 shtetet pjesëmarrëse në Kupën Botërore "Rusia 2018". Në fotografi janë dhënë flamujt e atyre shteteve!

TETËKAHËSHI (shtetet e KB)


Shtetet e dhëna gjejini në tetëkahësh. Me shkronjat e lira (lexuar me radhë), do t'i fitoni edhe tre shtetet e mbetur (të radhitur sipas alfabetit) si dhe njërin nga qytetet, ku u mbajtën ndeshjet. Në foto është stadiumi i atij qyteti, "Fisht"!

DEKODIMI

Fjala e kërkuar fillon nga katrori i vogël dhe përfundon te rrethi.

Duhet të zgjidhni njërën nga katër shkronjat në secilën fushë dhe të vazhdoni në fushën tjetër.

Në fund, lexuar me radhë fitohet zgjidhja e kërkuar (një shtet aziatik).



Zgjidhja:

P	A	NJ	A	P	S	A	I	N	O	P	A	J	P	A	
A	R	A	B	I	A	S	A	U	D	I	T	E	O	K	
K	O	S	R	T	U	N	S	G	A	A	I	K	R	I	
L	O	E	I	A	S	E	A	U	U	J	U	O	T	R	
A	E	R	P	D	N	C	S	M	A	I	K	L	U	A	
I	A	B	E	E	N	T	A	U	A	A	O	U	G	T	
R	N	I	G	A	R	A	G	D	Z	J	R	M	A	S	
E	G	A	R	A	J	U	N	M	N	V	A	B	L	O	
G	L	F	L	I	R	U	I	I	E	A	M	I	I	K	
I	I	I	C	U	R	A	G	T	T	K	L	A	A	R	
N	A	I	C	A	O	R	K	O	P	N	S	S	S	U	
A	K	R	A	M	I	N	A	D	R	I	E	I	I	S	
G	J	E	R	M	A	N	I	A	O	Ç	E	G	J	K	I
I	B	R	A	Z	I	L	I	N	A	R	I	E	R	A	
T	U	N	I	Z	I	A	A	K	I	G	J	L	E	B	A

“Nëse ndodhë që Vatikanit të njohë Kosovën, atëherë për këtë fajtor është ish-presidenti Nikoliq i cili kishte anuluar vizitën e Papës që ishte paralajmëruar”, ka thënë ministri i Jashtëm, Ivica Dačić

Në Serbi ka shpërthyer një debat në mes të ministrit të Jashtëm Ivica Dačić dhe opinionit atje, rreth marrëdhënieve të tendosura të Vatikanit me Beogradin zyrtar. Ministri i Jashtëm Ivica Dačić thotë se nëse Papa dhe lidhshiptari i Vatikanit vendosin që ta njohin Kosovën, atëherë fajtor është ish-Presidenti Tomislav Nikoliq. Sa Nikoliqi ishte President i Serbisë, Papa kishte caktuar agjendë për ta vizituar Serbinë, por ky shtet edhe me rekomandimin e Kishës Ortodokse Serbe, i kishte anuluar vizitën në Serbi të kreut të Vatikanit.

Lidhur me këtë që tani po cilësohet edhe si incident diplomatik, Dačići, ka bërë publike në media korrespondencën e ish-presidentit serb me Vatikanin, lidhur me vizitën, e më pas edhe anulimin e saj. Për këto publikime ai po kritikohet në Serbi, por Dačići është përgjigjur se nëse ndodhë që Vatikanit të njohë Kosovën, atëherë për këtë fajtor është Niko-

SI E SHEH BEOGRADI (MOS) NJOHJEN E KOSOVËS NGA VATIKANI?



lici dhe jo ai personalisht, shkruan Gazeta Metro.

“Unë nuk kam shkaktuar dëme ndaj shtetit duke botuar të vërtetën për vizitën e Papës, por dëmi shkaktuar fillimisht u shkaktua nga Tomislav Nikolic, pasi anuloi vizitën e kreut të Kishës Katolike Romake”, ka thënë Dačići.

“Nëse Nikoliqi i kërkoi leje Kishës serbe për vizitën e Papës, pse ai nuk e pyeti atë para se ta ftonte kreun e Vatikanit. Një Papë është jo vetëm një udhëheqës fetar, por edhe kreu i shtetit që nuk e ka njohur Kosovën, dhe kjo është e rëndësishme për ne për të luftuar

për krahinën tonë jugore. Kështu, me këtë anulim të vizitës, do t'i lejojmë Papës të shkojë në Prishtinë, por ai nuk mund të vijë në Serbi. Mos u ankoni më pas nëse Vatikanit njeh Kosovën”, tha Dačići për Večernje Novosti.

Duke folur për rivalitetin në mes të ortodoksizmit dhe katolicizmit, Dačići theksoi se numri një i Vatikanit, edhe para se të vendoste të shkonte në Serbi, kishte vizituar vende të tjera me shumicë ortodokse. Tutje, Dačići ka thënë se është e papërgjegjshme që shteti të konsultojë vetëm Kishën, dhe ta anulojë vizitën. Sipas tij, në

fund të fundit, nëse Kisha serbe, po e udhëheq shtetin, atëherë çfarë lloj presidenti do të ishte një president i tillë.

Vizita e Papës në Serbi ishte paraparë në janar 2016. Më pas, Vatikanit konfirmoi datën e vizitës më 21 ose 22 maj dhe dërgoi një shënim që sugjeroi se delegacioni i Vatikanit do të shkojë në Beograd më 24 janar dhe do të fillojë përgatitjet për vizitën e caktuar për 21 dhe 22 maj. Megjithatë, zgjedhjet u shpallën më pas në Serbi, dhe kjo u përdor nga ish-presidenti serb si arsye për të anuluar vizitën e Papës.

DËSHMI TRONDITËS E GAZETARI SERB PËR OLIVER IVANOVIQIN



Gjurmët e krimit të çojnë në zyrën e Marko Gjuriqit

Gazetari serb Stefan Cvetković që u dhunua brutalisht dhe që ishte pjesë e një grupi investigativ që po hetonte vrasjen e mistershme të liderit të serbëve të Kosovës Oliver Ivanović, ka lëshuar një deklaratë të fortë.

Cvetković është shprehur se gjurmët për vrasjen e Ivanovićit të çojnë në zyrën e Gjuriqit. Sipas tij, vrasësit e liderit të serbëve të Kosovës kishin kontakte të ngushta me disa individë nga zyra për Kosovën në Beograd.

“Ivanović është ekzekutuar. He-timi tregon për ekzistencën e dyshimeve se organizatorët e vrasjes së Ivanovićit kishin kontakte të ngushta me individë nga zyra për Kosovën në qeverinë e Serbisë”, - tha Cvetković, transmeton lajmi.net.

Në një konferencë për media gazetari serb bëri të ditur se ka qenë disa herë në Kosovë, ku ka pasur edhe kontakte me prokurorin special në Kosovë. Në konferencën për media gazetari doli me fashë në kokë, pasi dy netë më parë ai u sulmua brutalisht në një kafene.

Cvetković theksoi se emri i personit që tentoi t'a vrasë vlen, por për të më e rëndësishme është të dije se kush e dha urdhrin. Ai bëri me dije se u godit me një shufër metalike.

Nga fotografitë që qarkulluan në rrjetet sociale, shihet se Cvetković kishte një të çarë në sy. Gazetari që po heton vrasjen e Ivanovićit, u raportua si i zhdukur më 13 qershor.

Pse u takua Haradinaj me shefin e “nëntokës” së Veriut?

Kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj ka komentuar takimin e djeshëm me kryetarin e Listës Srpska, Goran Rakiq dhe me nënkryetarin Milan Radoičiq, i cili konsiderohet si shefi i “nëntokës” në Veri.

Në fotografitë e shpërndara dje nga Zyra e kryeministrit, Radoičiq është ulur në karrigen e mysafirit kryesor të kryeministrit sado që në subjektin politik Lista



Serbe ai mban pozitë më të ulët se mysafiri tjetër, Goran Rakiq, shkruan OralInfo. I pyetur lidhur

me këtë takim, Haradinaj tha se me Kryetarin dhe nënkryetarin e Listës Serbe biseduan për temat e

sigurisë. “Kam biseduar me Listën Serbe kam biseduar me Goran Rakiq dhe Milan Radoičiq, bisedat janë partneriteti me Listën Serbe. Mirë është që të vijmë por qeveria nuk po e ka problem mungesën e një shumicë të caktuar dhe humbin ata vetë”, tha Haradinaj. Ai potencoi se bojkotimi i pjesëmarrjes së kësaj partie në institucione është në dëm vetëm të tyre.



Ambasadorja e Turqisë në Prishtinë, Kivilcim Kiliç, deklaroi se dy vite pas përpjekjes për grusht shteti të kryer nga ana e organizatës terroriste FETO më 15 korrik të vitit 2016, Turqia ndodhet në një pozitë në të cilën vazhdon të zhvillojë ekonominë e saj duke forcuar demokracinë dhe institucionet e veta. Në një deklaratë për Anado-

Turqia pret që Kosova t'i dorëzojë edhe gylenistë të tjerë

lu Agency (AA), ambasadorja Kivilcim Kiliç theksoi se që nga kjo përpjekje për grusht shteti, Turqia është duke e zhvilluar ekonominë e saj në kuadër të masave të marra në bazë të ligjit për të pastruar institucionet nga mbetjet e FETO-s. Ajo deklaroi se edhe këtë vit, si vitin e kaluar, do t'i kujtojnë dëshmorët të cilët pa frikë kishin dalë në rrugë për ta mbrojtur demokracinë më 15 korrik kundër realizatorit të sulmit tradhtar të organizatës terroriste FETO. Kiliç njoftoi se nën organizim të ambasadës turke në Prishtinë do të mbahet edhe ceremonia përkujtimore e 15 korrikut.

Duke nënvizuar se FETO është një organizatë jotransparente me qëllime tradhtarë dhe se strukturat e tilla nuk duhet të kenë vend brenda demokracive, Kiliç u shpreh e kënaqur me faktin se shumë shtete të botës dhe opinionet publike kanë filluar ta kuptojnë këtë.

“Strukturat e FETO-s janë duke u shqyrtuar me vëmendje në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ky është një zhvillim shumë serioz. Po ashtu, në vendet evropiane, në Gjermani dhe në Britani, në deklaratat e autoriteteve dhe në raportet e përgatitura është vërejtur qartë se nuk mund të mohohet fakti që prapa tentimit për grusht

shteti më 15 korrik qëndron FETO, e cila me strukturat e saj komplekse ka depërtuar për vite në burokracinë, ushtrinë dhe gjyqësorin e shtetit të Turqisë. Kjo tregon se tani kemi rezultate konkrete nga aktivitetet tona informuese të zhvilluara gjatë dy viteve të fundit”, tha Kiliç.

Kiliç potencoi se FETO ende është aktive në Ballkan, duke vazhduar të helmojë publikun me disa struktura dhe me të ashtuquajtura “institucione arsimore”.

Ambasadorja turke u shpreh se deportimi i gjashtë pjesëtarëve të FETO/PDY-së në muajin mars si rezultat i raporteve të përgatitura

dhe vendimeve të marra nga institucionet e Kosovës ka qenë një masë e rëndësishme parandaluese.

Kiliç tha se Turqia nuk dëshiron që një vend mik siç është Kosova të jetë një shtet që bën shkelje të detyrimeve ndërkombëtare dhe hap dyert e saj për terroristët. Diplomati turke, duke iu referuar disa lajmeve në media lidhur me dhënien e statusit të refugjatit për pjesëtarët e FETO-s në Kosovë, nënvizoi se Kosova duhet të rishikojë këto vendime në përputhshmëri me detyrimet e saj ndërkombëtare, dhe shtoi se pret të rishikojë këtë status.

Nëse Trump e ka seriozisht me këtë kërcënim, ende nuk dihet. Teorikisht mendohet një reduktim i angazhimit të SHBA në NATO, në rastin më ekstrem edhe prishja e plotë, tërheqja e amerikanëve nga aleanca transatlantike

ÇKA MUND TË NDODHË ME NATO-n PA AMERIKËN?



rritjen e shpenzimeve të mbrojtjes. Qeveria gjermane kërkon të japë vetëm 1,5% të prodhimit të brendshëm bruto për mbrojtjen deri në vitin 2024. Kjo është për Trumpin tërësisht e pamjaftueshme. Ai ankohet për një shpërndarje të padrejtë të barrës në aleancë. Sipas prognozave vetëm Greqia, Polonia, Rumania, e Lituania, Letonia, Estonia do të arrijnë plotësimin e kriterit për shpenzime 2% për mbrojtjen në vitin 2018.

Gjendjen momentale të NATO-s dhe efektet e deklarave të forta të Trumpit, i ka analizuar britanika The Economist.

"Aleanca Perëndimore ia vlen të ruhet. Në një botë të rrezikshme, gjithnjë e më autoritare, NATO mund të shërbejë si burim jetik që ofron siguri dhe si bastion i demokracisë. Por Aleanca nuk e ka mbijetesën të garantuar nga Zoti. Duhet ta meritojë vendin e vet, vazhdimisht. Pyetja është se si.

Hapi i parë është të mos e bësh punën edhe më të vështirë. Europa duhet të bëjë gjithçka që mundet për t'i mbijetuar instinkteve të Trump-it për ta përzier tregtinë me sigurinë. Përzierja e këtyre dy fushave do ta bënte Perëndimin më pak të sigurt e më të varfër", shkruan The Economist.

Donald Trump e përmendi gjatë konferencës për shtyp, në përfundimin e Samitit dyditor të NATO-s në Bruksel, ose më saktë, konfirmoi atë që dyshohej se po ndodhte pas kuintave.

Kërcënimi se Amerika mund të dilte nga NATO-ja i shkundi mirë të gjitha vendet anëtare të aleancës, që pranuan të rrisnin kontributet e tyre të mbrojtjes. E Trumpi e ka treguar se i bën realitet paralajmërimet e veta.

Por, si mund të dilet nga NATO? Praktikisht, kjo me sa duket është fare e lehtë. Në pikën 13 të marrëveshjes së aleancës së Atlantikut të Veriut thuhet: "Pas një vlefshmërie kohore 20-vjeçare të paktit, çdo shtet që ka lidhur ujdë mund të dalë nga kjo marrëdhënie, e kjo mund të ndodhë pikërisht një vit pas deklarimit të ndërprerjes së marrëveshjes përballë Qeverisë së SHBA, e cila do t'u njoftojë vendimin qeverive e shteteve të tjera".

Pra, një vit afat për ndërprerje të marrëveshjes, pa nevojë për të dhënë argumentim. Ndryshe nga Bashkimi Europian, në të cilin deri

pak vite më parë as që ishte parashikuar një dalje si "Brexit"-i, prandaj nuk ishte përcaktuar asnjë procedurë, "te NATO-ja, – shpjegon Deutsche Welle, – që prej themelimit të saj ekziston mundësia që të largohesh fare thjesht prej aleancës".

Në historinë 70-vjeçare të saj nuk ka pasur deri më sot asnjë dalje të vetme, por ka pasur largime nga struktura e saj ushtarake, që do të thotë se disa shtete vërtet kanë mbetur anëtarë të NATO-s, por për një periudhë të caktuar kohe nuk kanë dashur që t'i vënë

trupat e tyre në shërbim të strukturave komanduese të NATO-s. Të gjitha ato, megjithatë, e kanë tërhequr këtë lloj politike.

Pas deklaratave të Trumpit, 29 anëtarët e aleancës janë ulur në një takim të posaçëm në Bruksel. Nëse Trump e ka seriozisht me këtë kërcënim, ende nuk dihet. Teorikisht mendohet një reduktim i angazhimit të SHBA në NATO, në rastin më ekstrem edhe prishja e plotë, tërheqja e amerikanëve nga aleanca transatlantike.

Në samit Gjermania ka refuzuar të bëjë premtime të gjera për

PASOJAT E NGROHJES GLOBALE



Një e pesta e akullnajave në Kolumbi po shkrihen

Kolumbia ka humbur rreth një të pestën e shkëmbinjve akullnajore në shtatë vitet e fundit, për shkak të ndryshimeve klimatike, njoftuan sot autoritetet kolumbiane të mjedisit.

"Për shkak të motit ekstrem që lidhet me fenomene natyrore dhe ndryshimet klimaterike, sipërfaqja e përgjithshme e gjastë akullnajave kolumbiane është zvogëluar nga 45 kilometra katror në vitin 2010 në 37 në vitin 2017 (18%), sqaroi në një komunikatë për shtyp Instituti i Hidrologjisë dhe Meteorologjisë dhe studimeve mjedisore (IDEAN). Këto dy vitet e fundit, 5,8% e sipërfaqes së akullnajave të vendit është zhdukur, ndarë në dy vargmalet kryesore, Sierra Nevada del Cocuy dhe la Sierra Nevada Santa Marta (veri-lindje), dhe katër vullkanet Ruiz, Santa Isabel, Tolima dhe Huila (qendër). Me këtë ritëm, Santa Isabel mund të zhduket në dhjetë vitet e ardhshme, u shpreh Omar Franco, drejtor i IDEAN. Ministri kolumbian i Mjedisit, Luis Gilberto Murillo u shpreh se pasojat e ngrohjes klimatike janë të mëdha për vendin, duke specifikuar se 30% e biodiversitetit të Kolumbisë, shteti i dytë që ka shifrën më të madhe në botë pas Brazilit, mund të zhduket./ ATSH-AFP

Britania mbyll kufinj të europianët

Lëvizja e lirë e qytetarëve europianë në Britaninë e Madhe do të marrë fund. Me një mesazh të prerë në Facebook, kryeministrja Theresa May njoftoi mbylljen e kufijve për europianët që kërkojnë të jetojnë dhe punojnë në vendin ishullor.

"Nuk do të lejohen më njerëz të vijnë nga mbarë Europa me shansin se mund të gjejnë një vend pune këtu. Do të mirëpresim profesionistët, si mjekët, in-

fermierët apo inxhinierët, që do të ndihmojnë vendin tonë të zhvillohet, por për herë të parë pas dekadash, do të kemi kontroll të plotë të kufijve tanë. Vendos Britania e Madhe, dhe jo Brukseli, se kush duhet të pranohet të jetojë dhe punojë këtu".

Vendimi i kryeministres May vjen pas reagimeve të shumta që shkaktoi në Londër, plani i ri për raportet tregtare me BE, i cilësuar i tepër butë nga mbështetësit e



Brexit.

Qeveria britanike publikoi gjithashtu atë që njihet si "libri i bardhë", dokumenti ku renditen objektivat e rinj tregtar të Ishullit. Pas mbylljes së Samitit të NATO-s,

Britaninë e Madhe e viziton të premtën presidenti amerikan Donald Trump, ku sërish tregtia, këtë herë me SHBA-të, do të jetë në qendër të takimit me kryeministren May.

Trump pritët nga kryeministrja May, lavdëron ish-ministrin Johnson

Donald Trump ka kërcënuar Britaninë e Madhe se, me shumë gjasë "nuk do të arrijë" një pakt tregtie me Shtetet e Bashkuara, nëse plani i kryeministres Theresa May për "Brexit"-in do të përparojë.

Sipas asaj që ka deklaruar për "The Sun", plani i kryeministres britanike "ndoshta do ta vriste një marrëveshje", pasi kjo do të nënkuptonte që Shteteve të Bashkuara "u duhet të merren me Bashkimin Europian", në vend që të merren vetëm me Britaninë.

Ndaj deklaratave të Trumpit nuk ka pasur asnjë reagim nga



"Downing Street".

Theresa May është përpjekur të diskutojë një marrëveshje treg-

tie të lirë me Shtetet e Bashkuara, në ndalesën e parë të presidentit amerikan Trump në Britani, duke u

shprehur se "Brexit" ishte një "mundësi" për të krijuar rritje ekonomike për të dyja vendet.

Por, si për të theksuar kundërshtinë e tij ndaj planit të Mayt, Trump deklaroi gjithashtu se ish-Sekretari i Jashtëm britanik, Boris Johnson do të ishte një "kryeministër i madh", duke shtuar se "ai ka gjithçka i nevojitet".

Në intervistën e tij për tabloidin britanik, ai risolli në vëmendje kritikën ndaj kryebashkiakut të Londrës, Sadiq Khan, për sulmet terroriste të vitit të kaluar në kryeqytet, duke thënë se ai ka bërë "një

punë të tmerrshme".

Presidenti dhe bashkëshortja e tij u pritën me një ceremoni tape-ti të kuq në pallatin "Blenheim", në Oxfordshire, pasditen e së enjtes. Ata ishin duke darkuar me Mayn kur doli lajmi për intervistën e tij me gazetën britanike, e cila – sipas tij, – ishte bërë tekta gjendej në Bruksel. Pas publikimit të saj, zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë, Sarah Sanders tha se presidenti "pëlqen dhe respekton së tepërmi kryeministren May", duke shtuar se "kurrë nuk ka thënë ndonjë gjë të keqe për të".



REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejshme gjatë punësimit në sektorin publik (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR – 105/2018

për punësimin e 5 nëpunësve shtetëror nga grupi I, nëngrupi I në „Qeverinë e Republikës së Maqedonisë - Sekretariati i Çështjeve Evropiane “për vendet e punës në vijim:

1. UPR0101B03000 Ndhimës udhëheqës i realizues(ë)
sektorit për përgatitje të versionit kombëtar të drejtave të Bashkimit evropian

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca e gjuhës(linguistikë), shkenca juridike ose shkenca politike
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 31.414,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

2. UPR0101B04001 Udhëheqës i njësive për realizues(ë)
për kërkim dhe koordinim të procesit për kërkim, Sektori për përgatitje të versionit kombëtar të Acquis Communautaire (të drejtave të BE-së)

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca e gjuhës(linguistikë), shkenca juridike ose Administrim publik dhe administratë
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e prmtë
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 28.286,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

3. UPR0101B04002 Udhëheqës i njësive për realizues(ë)
kontroll buxhetore, Sektori për çështje financiare

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca juridike, Matematikë ose Administrim publik dhe administratë
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 28.286,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

4. UPR0101B04002 Udhëheqës i njësive për realizues(ë)
çështje arkivore, Sektori për informatikë dhe teknologji komunikative dhe çështje arkivore

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi, sipas ECTS ose të kryer shkallën VII/1, Shkenca juridike, shkenca ekonomike ose shkenca politike
- më së paku 4 (katër) vjet përvojë pune në profesion, ku së paku 1 (një) vit në vend pune në sektorin publik, përkatësisht së paku 6 (gjashtë) vjet përvojë pune në profesion, prej të cilave së paku 2 (dy) vjet në vend pune udhëheqës në sektorin privat

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve

- punë me të tjerë/punë ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara
- udhëheqje; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- certifikatë e dhënies së provimit të udhëheqjes administrative
- njohjen aktive të një prej tre gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 28.286,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Turk(e) 1.

5. UPR0101G04000 Referent i ri për çështje realizues(ë)
arkivore - zyrë, Njësia për çështje arkivore, Sektori për informatikë dhe teknologji komunikative dhe çështje arkivore

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalese për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VA ose niveli i kualifikimeve IV, sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 180 ose 240 kredi sipas ECVET ose SMKAP ose së paku arsim të lartë ose të mesëm
- me ose pa përvojë pune

Kompetencat e përgjithshme:

- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frëngjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:30 - 15:30
- Përshkrimi i orarit të punës: orari i punës duke filluar në mes orës 7:30 dhe 8:30 dhe përfundimi i të njëjtit në mes orës 15:30 dhe 16:30

Rroga neto: 13.149,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Shqiptar(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilin të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faqja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faqja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – të: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai incizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së administratës.

Faza e 3 – të: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – të.

SHKUPI HUMBI NGA RENXHERSI POR NUK ZHGËNJEU

RAMADANI I KËNAQUR, PENALLTINË E PA VETËM REFERI

"Ne jemi një skuadër që duhet të japim maksimumin në çdo ndeshje, dhe këtu kanë përfunduar vetëm 90-të minutat e para. Jemi dëshmitarë se shumë herë kanë ndodhur ndryshime prej rezultatit 2:0, normal kemi favor temperaturat, kemi favor gjithçka në anën tonë dhe jam i bindur që do e bëjmë më të mirën për të arritur një rezultat pozitiv" – u shpreh Ramadani

Shkup, 13 korrik - Skuadra e FC Shkupit nuk arriti t'ia prish debutimin ish-futbollistit të Liverpoolit tani trajner i Gllazgou Renxhersit, Stiven Xherard. Skuadra nga Çairi u mposht me rezultatin 2-0 nga Glasgou në sfidën e parë të turit të parë kualifikues të "Europa League". Kjo ishte ndeshja e parë e Xherard në krye të gjigandëve skoceze dhe e para për Shkupin pas vitit 2004, kur në skenën evropiane për herë të fundit u ndesh me Omonian nga Qipro. Djemtë e trajnerit Zekirja



Ramadani gjithsesi arritën të bëjnë një paraqitje shumë të mirë, madje në pjesën e parë ishte pafat, sepse gjuajtja e Lamçevskit u ndal nga traversa dhe mund të kishte kaluar në epërsi. Derisa, në praninë e 50 mijë spektatorëve në stadiumin "Ibrox Stadium", Renxher fitoi me golat e Marfi dhe Tarvenier me penallti në minutat shtesë, duke i dhanë kështu skuadrës skoceze një bonus të madh sa i përket kualifikimit në raundin e dytë. "Fituam, dhe arritëm të rruajmë golin, që donë të thotë se jemi mbrojtur mirë. Shënuam gol në minutën shtesë dhe kjo na jep lehtësim dhe komoditet më të madh. Kemi kontrolluar lojën tonë pothuajse gjatë

gjithë ndeshjes. Është ndeshja e parë e sezonit dhe duhet të jem i kënaqur. Megjithatë ka edhe një ndeshje dhe duhet të përgatitemi mirë", tha pas ndeshjes trajneri i Renxhersit, Stiven Xherard. Në anën tjetër Trajneri i FC Shkupit, Zekirja Ramadani tha se skuadra e tij nuk meritoi një disfatë të tillë me dy gola dallim. Ai tha se ka mbetur i kënaqur nga loja që shfaqën futbollistët, ndërsa ka kërkuar një qasje të njëjtë edhe në ndeshjen e kthimit në Shkup. "Ne jemi një skuadër që duhet të japim maksimumin në çdo ndeshje, dhe këtu kanë përfunduar vetëm 90-të minutat e para. Jemi dëshmitarë se shumë herë kanë ndodhur ndry-

shime prej rezultatit 2:0, normal kemi favor temperaturat, kemi favor gjithçka në anën tonë dhe jam i bindur që do e bëjmë më të mirën për të arritur një rezultat pozitiv" – tha fillimisht Ramadani. "Jam shumë i kënaqur me ekipin tim dhe penaltia erdh në minutat e fundit, mirëpo unë nuk dua ta komentoj aspak atë, pasi vetëm referi e pa atë penalti, askush tjetër", – deklaroi Rramadani.

Rezultati 2-0 sigurisht se e mban në lojë FC Shkupin, futbollistët e së cilës do të tentojë të përmbysin shifrat në sfidën e kthimit që do të zhvillohet të martën e ardhshme në stadiumin "Filipi i dytë" në Shkup.

ARRIHET
MARRËVESHJA

Shaqiri transferohet te Liverpooli

Xherdan Shaqiri do t'u nënshtruhet testeve mjekësore, përpara përfundimit të transferimit të tij prej 13.5 milionë sterlinash te Liverpooli, shkruan Xhejms Pers. "Reds" kanë arritur një marrëveshje me Stok Siti, pasi kanë paguar klauzolën e lirit të shqiptarit të kombëtares së Zvicrës. Shaqiri do të jetë nënshkrimi i tretë i kësaj vere për Jurgen Klopp. Ai ka pasur oferta nga e gjithë Evropa, pas rënies nga Premier Ligë e Stok Siti, por sapo Liverpooli konfirmoi interesin, zemra e tij ishte e vendosur që të lëvizte në "Anfield". 26-vjeçari, përfshirja e të cilit në Kupën e Botës së Rusisë përfundoi në 1/8 finale, pas humbjes me Suedinë, javën e kaluar, ka gjasa ta bëjë debutimin e tij të kuq gjatë turneut parasezonal të Amerikës, më vonë, këtë muaj. Jurgen Klopp beson se sigurimi i shërbimeve të një sulmuesi të tillë me përvojë do ta ndihmojë Liverpoolin në shtimin e thellësisë si skuadër.

Ajeti pranë rikthimit te Krotone

E ardhmja e Arlind Ajetit mund të vazhdojë të jetë te Krotone. Mbrojtësi i kombëtares shqiptare prej disa ditësh është rikthyer në bazë pikërisht te Torino klubi që zotëron kartonin e tij duke nisur fazën përgatitore për sezonin e ri me skuadrën "Granata", por te

Torino ka pak vend për Ajetin i cili nuk shikohet si një alternativë shumë e vlefshme nga trajneri Valter Mazzarri dhe sipas të gjitha gjasave kuqeziu do të ndryshojë sërish skuadrat. Gjasat më të mëdha janë që Ajeti të rikthehet te Krotone për të luajtur në Se-

rinë B dhe për të ndihmuar skuadrën kalabreze të rikthehet sa më shpejt në Serie A. Sipas asaj që raportojnë mediat italiane bisedimet mes dy klubeve për të bërë të mundur rikthimin e Ajetit te Krotone janë në një fazë shumë të avancuar.



HYSAJ NDRYSHON MENDIMIN

Dëshiron të ndjekë Sarrin te Çellsit

Elseid Hysaj duket i vendosur për të ndjekur trajnerin Maurizio Sarri në Londër. Kjo gjë bëhet e ditur nga burime pranë familjes së mbrojtësit tonë kuqeziu. Babai i tij, Gëzimi, madje, ka qenë në kryeqytetin anglez dhe ka biseduar me drejtuesit e Çellsit për detaje të transferimit. Synimi është i qartë: familja "Hysaj" dëshiron që të bashkohet në Londër, ku për momentin jeton edhe motra e Elseidit. Ish-

trajneri i Napolit, që do të marrë përsipër drejtimin e skuadrës në "Stamford Bridge", pas shkarkimit të Antonio Kontes, e ka në "paketë" Hysajn dhe dy-tre futbollistë të tjerë, në bisedimet me blutë e Londrës. Ai dëshiron ta marrë me vete shqiptarin, si pjesë e projektit që ka për drejtimin e skuadrës me pronar sheikun rus, Roman Abramoviç. Palët janë dakorduar për këtë lëvizje dhe kushtet kontrak-

tuale, por tani mbetet si do të procedohet me "divorcin" nga Napoli, sepse klauzola e lirit të Hysajt është 50 milionë euro. Mbetet të shihet reagimi presidentit De Laurentis, nëse do të këmbëngulë në këtë shumë, apo duke e parë se dëshira e lojtarit është për të ikur, por edhe trajneri Karlo Ançelotti nuk e konsideron si "mollë e ndaluar" për ta shitur, ndryshe nga paraardhësi i tij, do të bëjë zbritje të çmimit.



Në pajtim me nenin 84 të Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 124/15) Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, edhe përkundër tentimeve që të bëjë dorëzim të rregullt të akteve administrative të sjella në procedurë administrative bën shpallje publike me:

LAJMËRIM

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ka sjellë akte administrative që nuk mund t'i parashtrijë personalisht edhe atë:

1. Lajmërim nr. 16-2430/1 nga 02.03.2018 për Mihajllo Toshevski, rr. Negotino nr. 1/G, Manastir.
2. Lajmërim nr. 16-1415/1 nga 02.03.2018 për Pepi Dimitrov, f. Gabrevci, Konçe.
3. Vendim nr. 16-120/4 nga 14.05.2018 për MHEC EHLOEC SHPK, rr. Nikolla Parapunov nr. 41, Shkup.
4. Vendim nr. 16-656/2 nga 22.05.2018 për ENERGOFLUKS SHPK, rr. Crniçe nr. 31, Shkup.
5. Vendim nr. 0317-11225-2979/10 nga 21.05.2018 për Mitat Imetoski, rr. Ohridska nr. 125, Manastir.
6. Vendim nr. 25-1892/1 nga 23.04.2018 për ZZ Markova Reka, rr. 1 nr. 78 Lisiçe e Poshtme, Shkup.
7. Vendim nr. 25-1666/2 nga 12.10.2017 për SHTZ Tabana SHPKNJ, rr. Hristo Tatarçev nr. 74/12, Shkup.
8. Vendim nr. 25-1682/2 nga 12.10.2017 për SHTZ Tabana SHPKNJ, rr. Hristo Tatarçev nr. 74/12, Shkup.

Ftohen personat e lartpërmendur në afat prej tetë (8) ditëve nga publikimi i këtij lajmërimi të paraqiten në lokalet e Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural – Shkup për marrje të vendimeve, ndërsa nëse nuk paraqiten, ky lajmërim me shpallje publike do të konsiderohet si dorëzim i rregullt në pajtim me nenin 84 paragrafi 6 i Ligjit për procedurë të përgjithshme administrative ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 124/2015).

Në bazë të nenit 22 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2011, 11/2012, 39/2012, 13/2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015 dhe 27/2016), Drejtori i ÇKF "RASPEANA MLADOST" – Karposh – Shkup, publikon

SHPALLJE
Për punësim

1. -1 (një) – përkëdhelës me arsim të mesëm të mbaruar katërveçar dhe licencë valide për përkëdhelës, me ose pa përvojë pune për kohë të pacaktuar.
- 1 (një) – përkëdhelës me arsim të mesëm të mbaruar katërveçar dhe licencë valide për përkëdhelës, me ose pa përvojë pune për kohë të caktuar deri më 31.12.2018

Së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të paraqesin:

- dëshmi për arsim të mbaruar përkatës (dëftesë, diplomë, certifikatë),
- certifikatë të shtetësisë,
- licencë valide për përkëdhelës.
- certifikatë të mjekut,
- dëshmi për njohje të gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik;
- Dëshmi se nuk i është shqiptuar dënim ose sanksion për kundërvajtje ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës;
- Dëshmi të mos i jetë shqiptuar dënim me aktgjykim të plotfuqishëm me të cilin është gjykuar me veprë penale për dhunë familjare, marrje të personit të mitur, moskujdes apo keqpërdorim i personit të mitur, për veprë penale të akteve kundër lirisë së gjinisë, pa marr parasysh sanksionit të shqiptuar në të cilin në pajtim me ligjin është vërtetuar sjellje diskriminuese.

Afati për paraqitjen e dokumenteve është 5 ditë pune, nga dita e publikimit të shpalljes.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 45 ditëve të punës pas kalimit të afatit për paraqitje.

2. Orari i punës në vendin e punës:
 - përkëdhelës është 40 orë në javë (prej ditës së hënë deri ditën e premte), ndërsa orari ditor i punës është 8 orë dhe i njëjti është i shkallëzuar me orar në periudhë prej ora 06,00-18,00.

Neto pagesa fillestare për vendin e punës:

- përkëdhelës është 14.772,00 denarë,
- Dokumentacioni i dorëzuar pas afatit, i pakompletuar dhe i parregulluar nuk do të shqyrtohet.

Fletëparaqitja me dokumentet e nevojshme paraqitet deri tek:

ÇKF "RASPEANA MLADOST" – Karposh – Shkup
rr. "Rugjer Boshkoviq" nr. 6
tel: 02/3068 781
1000 Shkup

Në bazë të nenit 22,23,25 dhe 26 të Ligjit për marrëdhënie pune, ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 62/05,167/15...72/15), dhe neni 79-d, 79-g, 80,82,84,86 dhe 87 i Ligjit për arsimin fillor („Fl. zyrtare e RM., nr. 103/2008,145/15,30/16 ...127/16) dhe pëlqimin nr. 12-1032/1 nga data 29.01.2018, dhe 12-2177/2 nga data 07.03.2018 Ministrisë së arsimit dhe shkencës, Drejtori i shkollës fillore komunale "Naim Frashëri" Kumanovë, publikon këtë,

SHPALLJE PUBLIKE

për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2017/2018

1. Një vend pune shërbim profesional- psikolog i shkollës në zëvendësim deri në kthimin e psikologes nga pushimi i lindjes;
 2. Një vend pune hausmjeshtër me kohë të pacaktuar ;
 3. Gjashtë vende pune personel teknik-pastues për mirëmbajtjen e higjienës në shkollë me kohë të pacaktuar ,
- Kandidati duhet të ketë të kryer shkollimin përkatës për vendin e punës për të cilin konkurren, kurse caktimi në vendet e punës do të bëhet në bazë të nenit 79-d,79-g ,80,81,82,84,86 dhe 87 të Ligjit për arsimin fillor dhe neni 23 të Rregullores për sistematizimin e vendeve të punës në SHFK „Naim Frashëri“, në Kumanovë.
- Angazhimi në detyrat e punës do të jetë në dy ndërrime, kurse rroga do të paguhet sipas LMP dhe kriterëve të MASH për pagesën e rrogave dhe kompensimeve tjera të të punësuarve në arsimin fillor në Republikën e Maqedonisë.
- Lutjes (CV) duhet të bashkëngjiten dokumentet e nevojshme edhe atë :
- diploma për kryerjen e shkollimit përkatës original ose kopje të vërtetuar të notari,
 - certifikata mbi shtetësinë e RM original ose kopje të vërtetuar të notari;
 - certifikata e lindjes original ose kopje të vërtetuar të notari;
 - certifikata që nuk është i,e dënuar apo nën hetime për veprë penale, ndalesë për ushtrimin e profesionit,detyrës etj.;
 - certifikata për gjendjen shëndetësore;

Shpallja mbetet e hapur 5 (pesë) ditë pune nga dita e shpalljes në shtypin ditor,kurse zgjedhja për vendet e punës do të bëhet në afat prej 15 ditëve nga përmbyllja e shpalljes publike.

Lutjet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit të paraparë nuk do të merren parasyh gjatë shqyrtimit.

Kandidatët dokumentet e kompletuara mund të dorëzojnë drejtpërdrejtë në administratën e shkollës, apo në adresën: Sh F K "Naim Frashëri" rr. Vuk Karagjiq p.n. 1300 Kumanovë.

Drejtori,
Muhamet Zeqiri

IPSH ENTI PËR PREVENTIVË SHËRIM DHE REHABILITIM TË SËMUNDJEVE KRONIKE, RESPIRATIVE JOSPECIFIKE DHE ALERGIJE OTESHEVË

Në bazë të nenit 22, 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 145/14"), neni 156, 157, 158, 159, 160, 161 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 43/2014), neni 7 dhe 8 të Marrëveshjes kolektive të veprimtarisë shëndetësore të RM ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 60/2006"), Pajtimin për punësim të Ministrisë së financave nr. 03 – 353 nga 03.07.2018, Vendimit për publikim të shpalljes publike nr. 04 -363/1 nga Drejtori, IPSH Enti për rehabilitim Oteshevë publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim të Doktorit specialist të medicinës interne për kohë të pacaktuar të punës në IPSH Enti për rehabilitim Oteshevë.

1. IPSH Enti për rehabilitim Oteshevë ka nevojë për punësim të Doktorit specialist të medicinës interne për kohë të pacaktuar të punës.
2. Kandidatët për praninë të Doktorit specialist të medicinës interne të paraqitur në shpalljen publike duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme në vijim:
 - Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
 - Të jetë i moshës së rritur,
 - Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore,
 - Të mos i jetë shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për realizim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.
3. Krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligj nga pika 2 kandidatët për Doktor specialist të medicinës interne duhet të përmbushin kushtet e posaçme në vijim:
 - Arsim sipëror të mbaruar – Fakulteti i medicinës,
 - Provim të dhënë specializimi për medicinë interne,
 - Provim të dhënë profesional,
 - Licencë për punës,
 - Me dhe pa përvojë pune.
4. Si shtojcë me fletëparaqitjen kandidatët për Doktor specialist të medicinës interne duhet të paraqesin dokumentet në vijim:
 - Fletëparaqitje me të dhënat për kontakt
 - Biografi të shkurtë
 - Diplomë me sukses mesatar
 - Certifikatë të shtetësisë së RM, original ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë nga mjeku jo më të vjetër se 6 muaj, original ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë se nuk i është shqiptuar ndalesë e plotfuqishme për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në original ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë për fakultet të mbaruar të medicinës, original ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë për provim të dhënë specializues të medicinës interne, original ose kopje të vërtetuar në noter
 - Certifikatë për provim të dhënë profesional, original ose kopje të vërtetuar në noter
 - Licencë për punë, original ose kopje të vërtetuar në noter
5. Orari i punës është 40 orë.
6. Neto pagesa fillestare për vendin e punës Doktor specialist të medicinës interne është 47.098,00 denarë.
7. Afati për paraqitje është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes.
8. Dokumentacioni i parastruar pas afatit, jo i plotë nuk do të jetë lëndë shqyrtimi nga ana e komisionit për përzgjedhje të kandidatëve.
9. Pas përzgjedhjes së realizuar të kandidatëve të paraqitur që i përmbushin kushtet në pajtim me shpalljen publike, do të realizohet provim kualifikues në pajtim me nenin 160 paragrafi 2 të Ligjit për mbrojtje shëndetësore.
10. Fletëparaqitja me dokumentacion të plotë dhe telefon për kontakt, të paraqitet përmes postës në adresën IPSH Enti për rehabilitim Oteshevë, me shenjë për shpallje publike për punësim.

IPSH Enti për rehabilitim Oteshevë

Koha
http://www.koha.mk

www.koha.mk
koha@koha.com.mk | marketing@koha.com.mk
Tel: 02 3179 - 904; Fax: 02 3118 - 060;
Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovasja lok.14 - përdhësë, Shkup

URGJENTISHT

Shes truall të urbanizuar 890 m2 me markë ndërtimore 430 m2, lartësia 8,5 m, Bo + Pr + 1 + Nën, trualli i parë në "Momin Potok" – Shkup, industria e lehtë, asfalt, ndriçim të rrugëve, autobus, rrymë elektrike, ujë, kanalizim, telefon, internet, gardh, parking dhe nënobjekte të ndërtuara ndërtimore (gjithsej 180 m2). Çmimi 165.000 euro. Tel. 078-201-960

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 070-775-703; 071 372 221

Urgjentisht shitet shtëpi në rr. Pere Toshev nr. 30 – Xhon Kenedi, Shkup me sipërfaqe prej 140 m2 oborr dhe 116m2 objekt banimi. Kontakt telefoni 072/643 093

SIPAS ASAJ QË RAPORTON TABLOIDI BRITANIK "SUN"

KONTE, MË I KEQ SE MURINJO

Të paktën sipas asaj që raporton tabloidi britanik "Sun", sezoni i fundit i trajnerit italian në drejtimin e Bluve të Londrës ka rezultuar të jetë një vit i ashpër. Sipas dy burimeve nga brenda klubit londinez, të cituara nga "Sun", por të paidentifikuara, faji ishte i vetë Kontes, që ngadalë humbi mbështetjen e të gjithë futbollistëve, duke filluar nga David Luiz e Diego Kosta, përmes sjelljeve që nuk janë pëlqyer nga vetë të interesuarit direkt

Një lamtumirë e shkruar, e preventivuar dhe që në përfundim ndodhi. Dalja nga Kobham në makinën e Kudiçini, mesazhet e lamtumirës së stafit dhe futbollistëve, gjithçka sipas skenarit. Konte nuk është më trajner i Çellsit, dhe si gjithmonë, edhe armikut më të madh i lejohet nderi uljes së armëve. Por jo, ky nuk është rasti i Çellsit dhe Antonio



Kontes. Të paktën sipas asaj që raporton tabloidi britanik "Sun", sezoni i fundit i trajnerit italian në drejtimin e Bluve të Londrës ka rezultuar të jetë një vit i ashpër. Sipas dy burimeve nga brenda klubit londinez, të cituara nga "Sun", por të paidentifikuara, faji ishte i vetë Kontes, që ngadalë humbi mbështetjen e të gjithë futbollistëve, duke filluar nga David Luiz e Diego Kosta, përmes sjelljeve që nuk janë pëlqyer nga vetë të interesuarit direkt. "Nga jashtë dukej sikur Konte të ishte në kontroll absolute të gjithçka, sikur zotëronte këtë etikë të jashtëzakonshme pune dhe se gjithçka shkonte sipas planeve në mënyrë të mrekullueshme. Por

ÇELLSI KONFIRMON SHKARKIMIN

Për shkarkimin e Antonio Kontes nga drejtimi i Çellsit konfirmimi gjatë ditës së djeshme ka ardhur edhe nga vetë klubi londinez. "Chelsea Football Club" dhe Antonio Konte kanë ndërprerë bashkëpunimin. Gjatë kohës së Antonio Konte në klubin tonë, në fituan titullin e gjashtë në Premier Ligë dhe kupën e 8-të në FA Cup. Në sezonin që fituam titullin, klubi vendosi një rekord me 30 fitore në 38 ndeshje në sezonin e Premier Ligë, po ashtu një rekord klubi me 13 fitore radhazi. I urojmë suksese Antonios në karrierën e tij", kjo është deklarata e klubit londinez. Vendin e Kontes pritet ta zërë një italian tjetër, Maurizio Sarri.

për futbollistët nuk ishte aspak njëllor. Ndonjëherë stërvitjet dilnin në program nga hiçi, nga një ditë në tjetrën. Edhe ndonjëri si Murinjo do të kishte bërë një program më të saktë, por do të kishite qenë edhe i gatshëm të ndryshonte ide nëse gjërat nuk do të

funksiononin, mbase duke kërkuar këshilla nga kapiteni ose drejtuesit. Konte, jo. Ose bëhej ajo që thoshte ai, ose dilje jashtë", citon "The Sun" njërin prej burimeve. Ndërkohë burimi tjetër i përmendur nga tabloid britanik deklaroi: "Hiqte ditët e pushimit pa asnjë paralajmërim dhe nuk i mbushej mendja ndryshe. Mbase futbollistët kishin programuar ndonjë udhëtim me familjet e tyre, por Kontes nuk i interesonte. Edhe Murinjo mund të gabonte, por futbollistët kishin shumë besim tek ai. Ishte i hapur ndaj sugjerimeve, krejt ndryshe nga Konte. Le ta themi troç: nëse je në gjendje të bëhesh armik me Uillian, që është një prej futbollistëve më të qetë në botë, atëherë mund të bëhesh armik me këdo", shkruan tabloidi britanik.

HIGUAIN PRET TELEFONATËN E SARRIT

Me zyrtarizimin e Kristiano Ronaldos, tashmë drejtuesit e Juventusit do të duhet të mendojnë për të rikuperuar një pjesë të shifrave të paguara për kartonin e portugezit. Emri më i mundshëm që duket se do të largohet për të sjellë para në arkat e klubit nga Torino, është ai i sulmuesit argjentin, Gonzalo Higuain. I ardhur nga Napoli për shumën e 95 milionë eurove, Higuain nuk ka bindur asnjëherë plotësisht në Torino, jo vetëm për numrin e golave të shënuar, por veçanërisht sepse nuk ka bërë asnjëherë diferencën në



ndeshjet e rëndësishme. Për sulmuesin pritet të futet në lojë Çellsit, por vetëm pasi të zyrtarizohet Maurizio Sarri, trajner me të cilin Higuain ka kaluar ndoshta periudhën më të artë të karrierës së tij. Drejtuesit e Juventusit nuk kanë ndërmend të heqin dorë nga numri 9 i tyre, për më pak se 55 milionë euro, por natyrisht që kjo shifër vështirë se do të ofrohej nga londinezët. Gjithsesi bëhet fjalë për një negociatë që mund të zgjasë shumë në kohë dhe mund të përfundojë vetëm në orët e fundit të merkatos.

NË PRITJE TË RONALDOS, JUVE PREZANTON KANSELON

Kam veshur këtë bardhezi për të fituar tituj

Në pritje të mbërritjes së Kristiano Ronaldos, Juventusit ka prezantuar mbremjen e sotme një tjetër portugez. Bëhet fjalë për mbrojtësin anësor Zhao Kancelo, i cili u ble nga Valencia për rreth 40 milionë euro dhe nënshkroi për 4 sezonet e ardhshme me bardhezinjtë. Natyrisht që Kancelo nuk mund t'u shpëtonte pyetjeve në lidhje me transferimin e shekullit, qoftë edhe për faktin se mbrojtësi ka luajtur në kombëtare me Ronaldon dhe e njëj me nga afër. "Ronaldo është

një blerje e jashtëzakonshme. Do të na ndihmojë shumë të rritim nivelin e cilësisë në skuadër dhe shpresoj që të fitojmë së bashku të tjerë trofe, pasi dihet që Ronaldo ka fituar thuajse gjithçka", deklaroi Kancelo. Ish mbrojtësi i Valencias luajti sezonin e kaluar te Interi, ku edhe shkëlqeu veçanërisht në pjesën e dytë të sezonit, ku u shndërrua në një titullar të padiskutueshëm i formacionit të Spalettit. Gjithsesi zikaltrit nuk mundën dot të ushtrojnë të drejtën e



blerjes, për shkak të "Fair Play-t Financiar", duke bërë që në këtë mes të përfitojë Juventusit. "Interi është një klub shumë i rëndësishëm për mua, pasi më ka ndihmuar të rritem shumë dhe të piqem si lojtar. Kundër Juventusit kam luajtur

ndeshjen më të bukur të karrierës time, por vishja bluzën zikaltrë. Tani kam veshur këtë bardhezi, për të fituar tituj, pasi dihet se Juventusit ka dominuar futbollin italian në vitet e fundit", deklaroi Kancelo.

JAJME SHKURT

Interi shet Ederin në Kinë

Eder është zyrtarisht lojtar i Jiangsu Suning. Sulmuesi i kombëtares italiane ka lënë përfundimisht Interin duke u transferuar në kampionatin kinez te klubi që është në pronësi të Zhang Jindong, manjatis aziatik që zotëron gjithashtu 70% të aksioneve të Interit. Në arkat e Interit për kartonin e futbollistit italo-brazilian, Jiangsu ka derdhur 5,5 milionë euro, ndërkohë që Eder ka firmosur me klubin kinez për 2 vite e gjysmë teksa do të përfitojë në total 13 milionë euro. Numri 23 largohet kështu nga zikaltrit pas 3 sezonesh në të cilat ka zhvilluar në total 86 paraqitje duke realizuar dhe 14 gola.

Kjaer drejt largimit nga Sevilja

Pas Lenglet, Sevilja mund të humbasë një tjetër lojtar të rëndësishëm në mbrojtje, Simon Kjaer. Lojtari danez që ishte protagonist me kombëtaren në Botërorin e Rusisë është në radarët e Marsejës dhe Lionit të cilët po përplasen për të njëjtin emër në merkato. Kjaer ka kontratë deri në vitin 2021 me andaluzët të cilët e paguan 12.5 milionë euro një vit më parë dhe tani kërkojnë të paktën 15 milionë euro për kartonin e 29-vjeçarit. Në Francë shikojnë ekipin e Marsejës si më të avantazhuar pasi edhe Rudi Garsia ka kontaktuar me lojtarin dhe tani mbetet për tu bindur Sevilja që të privohet nga një tjetër mbrojtës.

Murinjo "piketon" Maguiren

Hoze Murinjo ka mbrojtjen si prioritet për këtë merkato të verës dhe duke parë vështirësitë për të arritur te Varane, trajneri portugez ka kthyer sytë te Harry Maguire. Një nga më të mirët me Anglinë këtë Botëror mbrojtësi 25-vjeçar është i lidhur me një kontratë të gjatë me Leicester Siti që e bleu verën e kaluar për 20 milionë euro dhe tani mund ta shesë 3 herë më shumë, 60 milionë euro. Është kjo oferta që ka bërë Manchester Junajtedi për mbrojtësin dhe dëshiron ta mbyllë sa më shpejt pasi merkato në Angli këtë verë mbyllet me 9 gusht.

NUK PËRSËRITET “EURO 2016”, DO TA FITOJMË FINALEN E BOTËRORIT

“Tani është situatë ndryshe. Pas gjysmëfinale të Evropianit të kaluar, kur fituam kundër Gjermanisë, ne ishim pak euforikë, ndërsa kundër Belgjikës ishte ndryshe”, pohon Zhirud



Olivier Zhirud beson te mentaliteti dhe sipas tij, kjo është arsyeja pse ky ekip i Francës është i ndryshëm nga ai që humbi finalen e Kampionatit Evropian ndaj Portugalisë, në vitin 2016. Zhirud do ta udhëheqë sërish sulmin e “gjelave” në finalen e Botërorit të kësaj vere, ndaj Kroacisë, duke nisur si titullar çdo sfidë të këtij turne, përveç të parës. “Les Bleus” janë favoritët për të fituar trofeun, pas fitoreve mbresëlënëse kundër Argjentinës, Uruguait dhe Belgjikës. Për pasojë, 31-vjeçari thotë se Franca nuk do të lejojë një mundësi tjetër për t’i ikur nga duart, si në shtëpi, para dy vitesh. “Tani është situatë ndryshe. Pas gjysmëfinale të Evropianit të kaluar, kur fituam kundër Gjermanisë,

ne ishim pak euforikë, ndërsa kundër Belgjikës ishte ndryshe,—tha Zhirud. “Nuk është e njëjta ndjenjë. Ne e dimë që ende kemi një lojë për të fituar. Ka fokus dhe

përqendrim të vërtetë për ta përfunduar me sukses punën, prandaj është ndryshe. Kemi bërë një rrugë të gjatë për të arritur deri këtu dhe tani nuk duam ta humbim këtë mundësi. Ju nuk mund ta fitoni një Kupë Bote vetëm për talentin. Vetëm talentet nuk janë të mjaftueshme. Keni nevojë për efikasitet. Forca mendore është 70 për qind e punës. Nëse jeni gati të punoni për bashkëlojtarët tuaj dhe njëri-tjetrin me përkushtim, atëherë çdo gjë mund të ndodhë”, shtoi më tej Zhirud. Sulmuesi i Çellsit ende duhet të shënojë në Rusi, por e di se roli i tij është pjesë e një tabloje më të madhe në krijimin e bilancit dhe rrjedhshmërinë e ekipit. “Kundër Belgjikës kam humbur efikasitetin, më mungoi fati dhe diçka për të shënuar, por shpresoj se mund ta kem atë për finalen,—shtoi francezi.—Ndjehem sikur jap gjithçka për ekipin dhe, nëse një gol duhet të vijë, atëherë e mirëpres të dielën. Por, nëse jemi kampionë botërorë dhe nuk shënoj, jam në rregull me këtë”, përfundoi Zhirud.



Vendi i tretë, ngushëllim për Anglinë dhe Belgjikën

Botërorin e nisën me premtimin se do të ishin dy skuadra surprizë, me kuotat që u rritën shumë me kalimin e tureve, por duket se Anglia dhe Belgjika duhet të gjejnë ngushëllim tek medalja e bronzit, apo ndryshe vendi i 3-të në këtë Botëror. Nuk është e tepërt të mendosh që dueli i së shtunës është i padëshiruar për të dyja skuadrat, për vetë rrugën që kanë përshkruar për të arritur deri këtu. Të shortuara në të njëjtin grup si Belgjika ashtu dhe Anglia kanë arritur të befasojnë. Diçka më shumë kanë bërë Djajtë e Kuq, pasi kanë mposhtur 3 luanët në grup dhe deri në gjysmëfinale erdhën me fitore, madje duke eliminuar Brazilin që shihej si favoriti për të fituar turneun. 14 golat e shënuar deri më tani, përbërja e ekipit por dhe variacioni i ndryshëm taktik bënë që belgët me të drejtë të shiheshin me një tjetër sy. Vetë lojtarët pas eliminimit nga Franca janë shfaqur të zhgënjyer dhe tashmë duhet parë nëse dueli i vendit të tretë mund të rikthejë entuziazmin për të luajtur një tjetër sfidë të nivelit të lartë. Anglezët janë treguar më racional gjatë këtij Botërori megjithatë në gjysmëfinale shkuan me humbjen ndaj Belgjikës por duke thyer tersin e penalltive në duelin me Kolumbinë. Ecuria e skuadrës së Soutgejt zgjoi entuziazmin e një kombi të tërë, që pavarësisht eliminimit nga Kroacia sheh dritë në fundin e tunelit ku anglezët ishin futur prej vitesh. Finalja e vogël që do të luhet në Shën Petersburg është për krenari por dhe një mënyrë ngushëllimi pas zhgënjimit të gjysmëfinaleve.

Messi është si një karrocë dore në kalldrëm

Maradona u kthye për të përjashtuar Messin nga kritikën e tij ndaj ekipit të Argjentinës. “Ata e donin Leon për të zgjidhur të gjitha problemet. Në fakt, me ato pasime të Biglia, apo Enzo Perez, ai u kthye si një karrocë dore në kalldrëm”,—tha Maradona në programin e tij “Telesur”, nga Venezuela. Pastaj, ai nuk kurseu drejtuesit e Federatës Argjentine të Futbollit (AFA). “Historia shkon përmes cilësisë së udhëheqësve. Argjentina nuk po bën dot një ekip konkurrues, edhe pse ka mjaft lojtarë që dinë të

luajnë mirë futboll. Unë marr shembull Davor Shuker, të cilin e kisha partner te Sevilja. Ai drejton Federatën e Futbollit të Kroacisë dhe ka një marrëdhënie të jashtëzakonshme me lojtarët. Ata kanë një ekip të përgatitur për të dhënë gjithçka në fushë dhe janë në finale të Botërorit”,—shtoi Maradona. Më në fund, ai u ndal tek emri i Jorge Sampaolit, ende trajner i ekipit kombëtar të Argjentinës, të cilin e quajti “lojtar shahu” për shkak të ndryshimeve të vazhdueshme të sistemit të lojës.



SIPAS MEDIAVE BRITANIKE

Modriç duhet të fitojë “Topin e Artë”

Luka Modriç po udhëheq kombëtaren kroate në një sukses të jashtëzakonshëm, duke mbërritur tashmë në finalen e Kupës së Botës. Mesfushori kroat, që luan për Realin e Madridit, është aktualisht një kandidat i fortë për të fituar “Topin e Artë”. Pas ndeshjes me Rusinë, Modriç u pyet nga gazetarët në lidhje me fitimin e mundshëm të këtij çmimi prestigjioz individual, por u shpreh se për momentin ishte kombëtarja, ajo që i interesonte. Por Luka Modriç duket se do të jetë kandidati kryesor, edhe nëse nuk e fiton Kupën e Botës me Kroacinë, në finale ndaj Francës. Janë mediat, ato që i japin një dorë kandidatit të tij si fitues i trofeut më të lakmuar personal, që në dekadën e fundit ka pasur vetëm dy emra, Messi dhe Ronaldo. Është tabloidi prestigjioz britanik, “Dayli Mail”, që në një editorial kushtuar Luka Modriç thotë se ai duhet të jetë patjetër fitues i

“Topit të Artë” këtë vit. “Edhe nëse humbet finalen e Kupës së Botës, Modriç duhet të bëhet fitues i “Topit të Artë”, që është bërë pronë e Ronaldos dhe Messit prej vitit 2008,—shkruan “Dayli Mail” në versionin online.—Fitimi i Ligës së Kampionëve për herë të tretë dhe udhëheqja e Kroacisë drejt finale të Kupës së Botës është arritje e futbollit në 2018 dhe për këtë Modriç duhet të shpërblehet. Kështu, do të ishte hera e parë që ky çmim do t’i jepej dikujt tjetër, emri i të cilit nuk është as Lionel Messi dhe as Cristiano Ronaldo, që e kanë fituar atë prej vitit 2008”. Nëse Modriç do ta fitojë Kupën e Botës të dielën, ai do të bashkohet me një grup elitë, prej vetëm tetë lojtarësh, që kanë fituar me vendin e tyre dhe klubin dy herë më parë.

Në vitin 1974, Sepp Maier, Paul Breitner, Hans-Georg Shvarzenbek, Franz Beckenbauer, Gerd Myler dhe Uli Heness, fituan me Gjermaninë

Perëndimore, duke e bërë këtë edhe me Bajern Muni. Në vitin 1998, Kristian Karembeu fitoi me Realin e Madridit dhe Francën, ndërsa në vitin 2002, Roberto Karlos e bëri këtë me Brazilin dhe Realin e Madridit. Të dielën, Rafael Varane mund të arrijë dopietë me Francën dhe Realin e Madridit, por arritja e Modriç do të ishte më e madhe, pasi Kroacia ka rreth 800 futbollistë profesionistë të mirëfilltë në një popullsi prej katër milionë banorësh.

PERISHIÇ NË DYSHIM NDAJ FRANCËS

Ëndrra e Ivan Perishiç për të luajtur në finalen e Kupës së Botës mund të ketë përfunduar pasi ka pësuar një tërheqje muskulore. Perishiç ka marrë trajtimin e mjekëve në spitalin e Moskës ditën e enjte. 29-vjeçari, i cili është në radarin e një sërë klubesh të mëdha duke përfshirë edhe Manchester Junajted, shënoi golin e



barazimit në fitoren 2-1 ndaj Anglisë. Një pako me akull ishte vendosur në kofshën e tij për të zvogëluar fryrjen. Kjo ishte ndeshja e tretë radhazi që Kroacia luante 120 minuta dhe disa lojtarëve u është dhënë një ditë e plotë pushim. Franca do të jetë kundërshtari i Kroacisë ditën e diel.



DASHI 21. mars - 20. prill

Do të jeni të shqetësuar për shkak të disa debeteve që keni pasur së fundmi në familje. Keni qenë shumë agresiv dhe kjo për shkak të disa të papriturave me të cilat jeni përbalhur dhe që ju kanë humbur durimin. Përfitoni nga kjo fundjavë për të rregulluar çdo keqkuptim.

DEMI 21. prill - 21. maj

Në dashuri do të jeni shumë xheloz dhe kjo gjë mund të shkaktojë probleme edhe në disa projekte profesionale, duke iu shpërqendruar. Mundohuni që të jeni më shumë të kuptueshëm në raport me partnerin/en. Në vendin e punës priten konfirmime të reja.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Kjo e premte do të jetë mjaft e rëndësishme për të vlerësuar emocionet. Parashikohet një ditë mjaft e mirë për aleanca të reja dhe për të gjetur më shumë mbështetje në vendin e punës.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Është një ditë gjatë së cilës nuk përbaltoni dot shumë gjëra, për shkak se në këtë moment jeni tepër të angazhuar në punë, për t'iu dedikuar të tjerave. Parashikohen mundësi shumë të mira, për takime të reja.

LUANI 23. korrik - 22. gusht

Do të merrni përgjigje të rëndësishme, të cilat do ju lejojnë që të shikoni me sy tjetër disa situata sentimentale. Duhet të jeni më të vendosur sa i takon ndjenjave tuaja, pasi kjo është periudha me e favorshme për të kultivuar ndjenjat dhe raportin në çift.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Kjo ditë do ju gjejë mjaft romantik dhe ëndërritarë. Dashuria do të jetë epiqendra e kësaj të premteje, ku do e kaloni pa tensione dhe të shpërqendruar. Transaksionet janë mjaft të favorshme.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Po përkushtoheni maksimalisht për të arritur një objektiv profesional që i keni vendosur vetes. Por duhet të jeni më të organizuar për arritjen e tij, pasi një e papritur e vogël ekonomike, mund të ngadalësojë ritmin tuaj.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Mos u përfshini nga ankthi, pasi idetë dhe intuata juaj do ju lejojnë që të rregulloni çdo të papritur. Në dashuri duhet të jeni më spontan, sidomos nëse kohëve të fundit keni qenë konfuz. Analizoni mirë çdo detaj, para se të merrni një vendim përfundimtar.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Ka ardhur momenti që në sferën profesionale të riktheheni në lojë. Do të jeni të fortë dhe karizmatik, ndaj mos u stepni për të çuar përpara propozime të reja. Në dashuri do të jeni të përfshirë nga dyshimet.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Ky është momenti më i mirë për të rindezur pasionin. Së fundmi në dashuri do të jeni shumë të hutuar, për shkak të punës së tepërt. Kjo e premte është mjaft e favorshme për të bërë një arratisje romantike.

UJORI 21. janar - 19. shkurt

Kjo ditë do të jetë mjaft dinamike, sidomos nëse do ju duhet të dorëzoni një projekt vendimtar për karrierën tuaj. Këshillohet që të jeni shumë të kujdesshëm me shpenzimet, pasi mund të ketë të papritura të vogla.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Në vendin e punës ka tensione dhe kjo mund t'iu bëjë të ndiheni të frustruar. Megjithatë duhet të silleni me sa më shumë diplomaci, për të shmangur përplasjet e ndezura. Në dashuri parashikohet rikuperim.



PËRKUJTIM

FISNIK MARKU
(1969- 2014)

Një Yll që shkëlqeu ...

Ishe i denjë për emrin që mban dhe gjurmët që lë pas, ishe ëmbëlsia dhe dashuria vetë; modestia dhe bukuria e Njeriut. Kudo rrezatojë me harizmën tënd - i matur në fjalë, i paluhatur në qëndrime. ...e unë jetoj e vazhdoj të jetoj me mallin e frymën tënde, o bir ...Mamushi jot"

Me mall të madh, Fatime Marku, nga Dibra

	Koha Koha Koha	KËNGËTARI AMERIKAN, VONDER	GJYSHJA (krah.)	KAMPION	KËNGËTARI, SHKËLZEN	MALL, ARTIKULL, PRODHIM	TRA MBAJTËS I TAVANIT	
	AKTORI AMERIKAN, VESLI							
	KARTË ANËTARËSIE (shq.)							
	LUMË NË AUSTRI			ARMË E RËNDË ZJARRI				
	EMËR MASHKULLI MUSLIMAN			I DHËNË PAS HIPOTEZAVE			SHKENCA E DREJTËSISË	
	ITALIA		UJDHESË (sh.pashq.)					
	Koha Koha Koha	KRUJESI I VEPRAVE EPIKE						
		KULAÇE						
		PJESË E KURANIT	I LARMË	IRIDIUM	LUMË NË NIGERI		AUTOTARGA E TURQISË	
					HIDROGJEN		AI (frençl.)	
AKTORI YNË NGA FOTO							INDUKSION PASION I NGRITUR PATOLOGJIK SEKSUAL	
MASË BRITANIKE PËR GJATËSË				LLOJ MAJMUNI (MAJMUN MARIMANGË)				
				QË ESHTË LËNË I LIRË, PA FRE				
ERBIUM			SEMUNDJE E FËMIJËVE NGA ESHTRAT NAPË GRASH (shum.)			RADIO PRISHTINA		
						VOKALIZIM		
LUMI I LONDRËS					NJERI I PASHPIRTË, I PAMËSHIRSHËM			
					HUNGAREZ			
Koha Koha Koha	ZONJË (frençl.)					NË KËTË VEND		
	NDIHMËS MJESHTER (shq.)					AKTORI AMERIKAN, TOM		
ORGANIZATË HUMANITARE AUSTRIAKE							KËNGËTARI ANGLEZ, STJUART	
							AKTORI YNË, KADRI	
TENISTJA, KURNIKOVA				QYTET NË BELGJIKË	GJOBË, DËNIM NË TË HOLLA (turq.)			
					FRANÇEZ I VJETËR			
K, L, ...?		MENDJE-MADH						
		LOGARITMI NATYROR						
GODITJE ME PELLEMBË, SHUPLAKË							N. C.	
VEESHJE E SIPËRME SI PELERINË							METËR	
					NJË LËNDË MËSIMORE			

A është e mundur dy persona të ëndërrojnë të njëjtën ëndërr?

Nëse dy njerëz mund ta ëndërrojnë të njëjtën ëndërr, a do të thotë kjo që ëndrrat të kapërcejnë mendimet individuale të secilit individ? Hulumtimet në temën e ëndrrave është i pranishëm në botën e psikologjisë tashmë shumë vite, ndërkaq kohëve të fundit më së shumti vëmendje preokupon gjetja e përgjigjeve pyetjes a është e mundshme dhe në ç'mënyrë dy apo më shumë persona të ndryshëm, të cilët nuk kanë asgjë të përbashkët, të ëndërrojnë ëndrra identike.

Mjaft studime janë publikuar lidhur me temën e ëndrrave të përbashkëta në të cilat është arritur deri te zbulimi që te personat të cilët janë fuqishëm të lidhur emocionalisht (prind-fëmijë, bashkëshortët apo binjakët) ëndërrimi i ëndrrave identike shpesh ndodh, transmeton Telegrafi. Pos kësaj, shumë psikologë dhe psikoterapeutë shpesh ndajnë të njëjtën ëndërr me pacientët e tyre, gjë që edhe ata vetë konstatojnë.

Ndërkaq shkaku për iniciimin e tre-



gimit të ëndrrave të njëjta tek të tjerët absolutisht ka anekdota të shumta dhe përvoja të shumicës, ndër të cilët me siguri të gjithëve u është e njohur situata kur kalojmë pranë njëri-tjetrit në rrugë me dikë dhe mendojmë se si atë person e kemi parë diku. Tani për tani të gjitha konstatimet ende bazohen në anekdotat e përmendura më sipër dhe shkenca akoma nuk ka arsye të argumentuar fuqi-

shëm për këtë dukuri.

Veç kësaj, personat të cilat tregojnë të njëjtën ëndërr shpesh nuk pajtohen rreth disa detajeve, gjë që është edhe një arsye për skepticizëm. Mirëpo, psikologët megjithatë nuk dëshirojnë të injorojnë tregimet dhe përvojat, sepse zakonisht personat të cilët shohin të njëjtën ëndërr përjetojnë përditshmëri të njëjtë apo kalojnë kohën shpesh bashkërisht.

87-vjeçari që ka një familje me 346 pasardhës të gjallë!



Një burrë në Ukrainë po aplikon për Rekordet Gines sepse pretendon që ka familjen më të madhe në botë. Pavel Semenyuk gjithmonë ëndërronte për një familje të madhe dhe u emocionua kur gruaja e tij lindi 13 fëmijë. Dhe tani 87-vjeçari ka një familje me 346 anëtarë dhe më i vogli është dy javësh. Familja Semenyuk jeton në fshatin Dobroslav në rajonin jugor ukrainas të Odessa Oblast. Paveli ka një total prej 127 nipër e mbesa, 203 stërnipër e mbesa dhe madje 3 stër-stër nipër e mbesa, diçka që nuk është e zakonshme. "Është e gjitha një familje e madhe dhe e lumtur", tha ai, duke përmendur vështirësinë për të mbajtur mend emrat e të gjithë pasardhësve të tij. "Unë njoh emrat e atyre që janë më të mëdhenj. Por shpesh nuk më kujtohen emrat e të rinjve". Sa herë që njëri prej tyre nis të krijojë një familje, të tjerët ndërtojnë një shtëpi të re në fshat për çiftin e sapomartuar. Për ta bërë këtë, nuk ka mungesë të duarve, pasi shumica e djemve dhe e nipërve Pavelit merren me ndërtim.

Sheqeri më i rrezikshëm se duhani!

Çdo vit në botë vdesin rreth 35 milionë njerëz nga pasojat e përdorimit të tepërt të sheqerit, i cili plotësisht mund të çrregullojë punën e metabolizmit, të hormoneve dhe të mëlçisë, tërheqin vëmendjen profesionistët. Edhe pse sasia e vogël e sheqerit nuk paraqet problem, sasi të mëdha të përdorimit të çdo ditshëm të këtij "helmi" të ëmbël mbysin, ndërsa brenda vitit vdesin 35 milionë njerëz në gjithë botën, tregojnë shkencëtarët nga Universiteti i Kalifornisë.

Në shkrimin "E vërteta toksike për sheqerin", alarmojnë se shitja dhe përdorimi i sheqerit duhet të rregullohen me ligje dhe me vërejtje të posaçme, në mënyrë që të zvogëlohet përdorimi i përditshëm, shkruan në një të përditshme angleze. Dëshmohej se lëngjet e sheqerosura dhe ushqimi i ëmbël janë përgjegjëse për sëmundje, siç është trashësia, karcinoma, problemet me mëlçinë dhe me sëmundjet e zembrës. Sheqeri, jo vetëm që i trash njerëzit, veçse në përgjithësi e çrregullon metabo-



lizmin, "i nxjerr" hormonet nga ekuilibri, e rrit tensionin e gjakut dhe e dëmton mëlçinë. Efekt të njëjtë në trup ka edhe alkooli. Profesionistët propozojnë tatim më të madh mbi ushqimin dhe mbi pijet të pasura me sheqer (siç janë lëngjet e gazuara), kufizimin e blerjes nga të rinjtë nën moshën 17 ose 18 vjeç.

Sheqeri është njësoj si alkooli dhe duhani, keqpërdoret lehtë dhe është i dëmshëm për shoqërinë – thotë autori i hulumtimit dhe eksperti për trashësi, Ro-

bert Lustig. Njerëzit me kohë do të mësohen të zgjedhin prodhime më pak të rrezikshme. Sot ka më shumë njerëz me peshë të tepruar sesa me peshë normale, si pasojë e sëmundjeve të kohës. Edhe pse shkencëtarët nuk propozojnë ndalimin e shitjes dhe të blerjes së sheqerit, kërkojnë përgjegjësi më të madhe të prodhuesve si dhe informim më të mirë të njerëzve lidhur me ndikimin e sheqerit. Kjo është për të mirën e shëndetit të njerëzimit.

KALENDARI HISTORIK 14 KORRIK

1223 - Luigji VIII shpallet Mbret i Francës pas vdekjes së babait të tij, Filipit II të Francës.

1520 - Beteja e Otumbas në Meksikë: Hernan Korteza kundër Actekëve.

1535 - Perandori Çarls V pushton Tunizinë.

1544 - Trupat anglez sulmojnë Kanaanin.

1714 - Beteja e Alandës: Flota ruse mposhtë flotën më të madhe suedeze.

1789 - Dita e Bastiljes: Revolucioni francez fillon me rënien e Bastiljes.

1853 - Kryetari Frenklin Pirs hap ekspozitën e parë industriale - Nju Jork.

1927 - Fluturimi i parë komercial në Havai.

1938 - Musolini publikon manifestin kundër hebrenjve dhe afrikanëve.

1948 - Izraeli bombardon Kajron.

1949 - BRSS eksplodon bombën e tyre të parë atomike.


2002 - Kryetari francez Zhak Shirk i shmanget një tentimi të atentatit gjatë festimit të Ditës së Bastiljes.

2007 - Rusia tërhiqet nga Traktati i Forcave të Armatosura Konvencionale në Evropë.

Tërmetet në Hënë nuk janë fantazi shkencore. Por ata nuk ndodhin aq shpesh sa në planetin tonë. Zakonisht ndodhin shumë më thellë, pranë bërthamës së Hënës. Kjo ndodh prej forcave tërheqëse të Diellit dhe Tokës.



Ka ndodhur një herë në shekullin 15, kur fenomeni i quajtur si Epoka e Vogël e Akullit ndryshoi klimën në Tokë. Kjo epokë bëri që Islanda dhe Finlanda të humbinin një të tretën e popullsisë, ndërkohë që Vikingët u larguan nga Groenlanda.



Ç'FAJ KA PULA?

I thotë gruaja burrit:
- Nesër e kremtojmë dhjetë vjetorin e martesës. Ta therim pulën?
Burri i përgjigjet: E ç'faj ka ajo?!



Kushdo që ruan aftësinë për ta parë bukurinë, nuk ka për t'u plakur kurrë. (Franz Kafka)